



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Center for Civil Communications
Центар за граѓански комуникации



Hubuntim
**I PASOJAVE NGA RRRITJA
E SHPENZIMEVE
BUXHETORE NGA KRIZA
NË VITIN 2022 NË
FUSHAT TË CILAT
NDIKOJNË NË JETËN
E QYTETARËVE**

kWh



Projekti:

Efektet e krizës financiare dhe energjetike mbi politikat dhe qytetarët

Hulumtim

I PASOJAVE NGA RRITJA

E SHPENZIMEVE

BUXHETORE NGA KRIZA


NË VITIN 2022 NË

FUSHAT TË CILAT

NDIKOJNË NË JETËN

E QYTETARËVE

kWh



shtator 2023

“Hulmtim i pasojave nga rritja e shpenzimeve buxhetore nga kriza në vitin 2022 në fushat të cilat ndikojnë në jetën e qytetarëve”

Botues: Qendra për Komunikime Qytetare

Autorë: Sabina Fakiq, Pavle Gacov dhe German Filkov

Ekipi hulmues: Pavlinka Strezoska dhe Marko Mitevski

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe: Agon Ismaili

Dizajn grafik: KOMA

Printoi: KOMA

Tirazhi: 200

Tirazhi falas/jokomercial

ЦИП



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



CIVICA
MOBILITAS

| *Citizens for change!*

Projekti mbështetet nga Qeveria e Zvicrës përmes Civica Mobilitas. Mendimet e shprehura këtu nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e qeverisë zvicerane, të Civica Mobilitas apo të organizatave që e zbatojnë atë.

PËRMBAJTJA

GJETJET KRYESORE	<u>4</u>
KONTEKSTI	<u>6</u>
HULUMTIM I DETAJUAR NË PASOJAT NGA RRITJA E SHPENZIMEVE BUXHETORE NGA KRIZA NË VITIN 2022 NË FUSHAT TË CILAT NDIKOJNË NË JETËN E QYTETARËVE	<u>8</u>
ANALIZA E DETYRIMEVE TË INSTITUCIONEVE	<u>39</u>
PLANIFIKIMI DHE MONITORIMI I REALIZIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2022 – NEVOJA PËR HARMONIZIM TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË BUXHETIT	<u>42</u>
PROPOZIME-REKOMANDIME	<u>51</u>
MATERIALET DHE BURIMET E TË DHËNAVE QË JANË PËRDORUR	<u>53</u>

GJETJET KRYESORE

- Për të mbuluar shpenzimet në rritje nga kriza energjetike në vitin 2022, qeveria sakrifikoji një sërë objektivsh kapitale në vlerë prej së paku 170 milionë euro, siç janë: renovimi i enteve shëndetësore, blerja e pajisjeve mjekësore, ndërtimi i kopshteve për fëmijë dhe shtëpive për të moshuarit, ndërtimi i rrugëve, rikonstruksioni i konvikteve studentore, si dhe projekte për përmirësimin e mjedisit jetësor. Kur t'i shtohen kësaj shume edhe 50 milionë euro projekte kapitale që duhet të realizohen nga ana e autoriteteve lokale, rezulton që, për shkak të krizës energjetike, këtë vit janë sakrifikuar projekte të rëndësishme për qytetarët me vlerë prej së paku 220 milionë euro.
- Shpenzimet kapitale në vitin 2022 janë realizuar për 163 milionë euro më pak se sa shuma fillimisht e paraparë. Gjatë kësaj, nga totali i shpenzimeve kapitale të realizuara në vlerë prej 465 milionë euro, madje 28% përkatësisht, 131 milion euro janë shpenzuar për pagesa të cilat nuk mund të cilësohen në kategorinë "kapitale". Bëhet fjalë për një pjesë të pagesave ndaj SHA 'Elektrani' për tejkalimin e krizës energjetike në vlerë prej 97 milionë euro, pagesa të garancive me këste për kredi të SHA për Rrugët Shtetërore dhe të Hekurudhave të RMV-së Transport SHA Shkup (30 milionë euro), si dhe pagesat ndaj SHA Posta (2 milionë euro) dhe SHA Ekonomi me Ujëra (1.8 milion euro), të cilat gjithashtu janë në lidhje me krizën energjetike.
- Mbështetja totale buxhetore e SHA 'Elektrani' në vitin 2022 kur ishte kriza, arrin shumën prej 230 milionë euro. Nëse kësaj shume i shtohet edhe mbështetja buxhetore prej 86 milionë euro për të njëjtin dedikim, e paguar ndaj ESM në tremujorin e fundit të vitit 2021, si dhe 62 milionë euro të paguara në nëntë muajt e parë të vitit 2023, rezulton që mbështetja totale e prodhimit vendor për shkak të krizës energjetike është 378 milionë euro.
- Rritja e shpenzimeve për ngrohje në vitin 2022 vlerësohet të jenë në shumë prej 59 milionë euro në raport me vitin 2021. Në përlogaritjen e këtyre shpenzimeve, të cilat në total vlerësohet se janë 108 milionë euro, krahas shpenzimeve të paguara nga llogaria përfundimtare e Buxhetit të RMV-së, janë përfshirë edhe detyrimet që kanë maturuar në vitin aktual, por që nuk janë paguar. Nga këto shpenzime janë paguar 83 milionë euro, ndërsa 25 milionë janë të papaguara.
- Viti 2022 i krizës reflektohet në Buxhet përmes rritjes së kostove për ngrohje, rritjes së ngarkimeve me borxhe, rënies së aftësisë së institucioneve për t'i paguar me kohë detyrimet dhe rritjes së nevojës për ndërhyrje më të mëdha nga buxheti qendror i shtetit.
- Detyrimet totale të raportuara të subjekteve buxhetore në fund të vitit 2022 kanë qenë 800 milionë euro dhe në raport me vitin 2021, ato janë rritur për 186 milionë euro shtesë, përkatësisht për plotë 30%.
- Në SHËNDETËSI, në vitin 2022 të krizës, më së shumti shkurtime janë bërë në rekonstruksionet dhe zgjerimin e objekteve shëndetësore, për çka ka qenë e paraparë të shpenzohen 14 milionë euro, mirëpo janë shpenzuar vetëm 3.5 milionë euro, që paraqet dështim në realizim edhe atë për 75%.
- Në fushën e MBROJTJES SOCIALE, në vitin 2022 nuk janë realizuar dhe as nuk kanë filluar të realizohen 7 projekte ndërtimore me vlerë 5.5 milionë euro. Bëhet fjalë për objekte të dedikuara për të moshuarit, për persona me pengesa dhe për fëmijët nga kopshtet për fëmijë.
- Investimet në ARSIM në vitin 2022 janë pothuaj të përgjysmuara dhe nga 20 milionë të buxhetuara fillimisht, janë realizuar vetëm 10 milionë euro.
- Programi për PËRMIRËSIM TË MJEDISIT JETËSOR, nga 30 milionë euro është zvogëluar në realizim të shumës prej vetëm 13 milionë euro.

- Në fushën e BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE EKONOMISË ME UJËRA, për nënprogramet “Hidrosistemi Zletovicë” dhe “Modernizim i bujqësisë” të planifikuara kanë qenë 4.5 milionë euro ndërsa janë shpenzuar vetëm pak më shumë se 1 milion euro.
- Investimet në INFRASTRUKTURËN RRUGORE me Buxhetin për vitin 2022 fillimisht kanë qenë të planifikuara në shumë prej 96 milionë euro, që më pas të anulohen, ndërsa është bërë shkurtrim i mjeteve edhe për projektet e furnizimit me ujë dhe për kullimin e ujërave të zeza.
- Shkurtrim i madh i mjeteve është evidentuar edhe në REFORMAT NË INSTITUCIONET NDËSHKIMORE-KORRIGJUESE. Nga shuma fillimisht e planifikuar prej 4.6 milionë euro, janë realizuar vetëm 127 mijë euro.
- Pa realizim kanë ngelur edhe planet për rinovimin e ambasadave, përfaqësive diplomatike dhe rezidencave të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Brazilia, Kanberë, Athinë, Budapest, Zyrë dhe Harare.
- Në vitin 2022 nuk janë blerë PAJISJET për TI, që kanë qenë të planifikuara për Drejtorinë e të Ardhurave Publike (DAP), as nuk është bërë zgjerimi i pajisjeve ekzistuese dhe konsolidimi i bazave të të dhënave në vlerë 800 mijë euro.
- Shpenzimet e larta në segmentin e pagave dhe kompensimeve, subvencionimi i sektorit energjetik, si dhe trendi i përgjithshëm i rritjes së kostove, duke përfshirë transferet ndaj fondeve sociale dhe rritja sistematike e pjesës së mjeteve të grumbulluara në bazë të tatimit mbi të ardhurat personale dhe të TVSH-së e cila transferohet në favor të buxheteve komunale, i ngarkon financat publike dhe si pasojë, anulohet efekti i dividendës së inflacionit në të ardhurat buxhetore, ndërkaq deficitit buxhetor dhe ngarkimi me borxh mbeten si opsione për zgjidhjen e deficiteve. Ngarkimi me borxh do të jetë një ngarkesë buxhetore (shpenzim buxhetor) në të ardhmen në përputhje me kushtet e dakorduara për financim të deficitit.
- Ekziston një bilanc i madh i kërkesave të papaguara në bazë të detyrimeve publike të papaguara (në bazë të TVSH-së nga qarkullimi në vend dhe nga importi, tatimi mbi fitim, tatimi mbi të ardhurat personale, akcizat dhe doganat) të cilat, sipas të dhënave të Drejtorisë së Ardhurave Publike arrijnë shumën prej më shumë se 143 milionë euro. Efektet e arkëtimit eventuale të kërkesave të papaguara dhe të masave ligjore që janë ndërmarrë për arkëtimin e kërkesave të papaguara nuk janë prezantuar publikisht.
- Hulumtimi sugjeron në dobësi të kontabilitetit buxhetor të bazuar në para të gatshme, në mungesë të harmonizimit të raportimit financiar dhe në evidentimet e ndryshme financiare të transaksioneve të njëjta juridike dhe ekonomike.
- Institucionet kanë demonstruar një nivel jashtëzakonisht të dobët të përgjegjësisë në raport me projektet e planifikuara e të parealizuara, që në situata të caktuara nxit pandehje edhe për fshehje të vetëdijshme të informacioneve prej publikut.
- Miratimi i vendimeve për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, gjatë kësaj, pa qenë i përgatitur dhe i shpallur Buxheti i ndryshuar, e vështirëson këqyrjen e publikut në ndryshimet e bëra dhe e imponon nevojën për ndryshime urgjente në atë drejtim.
- Për shkak të një gabimi në Propozim- Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit të RMV-së për vitin 2022, nuk ishte e mundur të bëhet analizë në ndikimin e krizave mbi funksionet e shtetit: shërbimet e përgjithshme publike, mbrojtja, rendi dhe qetësia publike, çështjet ekonomike, mbrojtja e mjedisit jetësor, vendbanimet dhe zhvillimi i komunitetit, shëndetësia, rekreacioni, kultura dhe feja, arsimit dhe mbrojtja sociale.

KONTEKSTI

Qytetarët e Maqedonisë së Veriut po jetojnë në periudhën më të pasigurt dhe më të vështirë ekonomike në 20 vitet e fundit. Ajo që filloi si krizë shëndetësore, me pandeminë COVID-19, shpejtë u shndërrua në krizë ekonomike dhe financiare, ndërsa vitin e kaluar, veçanërisht pas shpërthimit të luftës në Ukrainë, vendi dhe qytetarët u përballën edhe me krizë energjetike.

Krizat ndikuan me uljen e të hyrave në buxhet për shkak të uljes së konsiderueshme të aktivitetit ekonomik, e ndërkohë u shtuan nevojat dhe u rritën çmimet për shumë produkte bazë. Përveç ndikimit negativ të krizave në financat publike, ato ndikuan veçanërisht në mënyrë negative të njerëzit, në standardin e tyre të jetesës, madje edhe në disa nga të drejtat e tyre themelore. Në veçanti janë prekur grupet e varfra dhe të marginalizuara, situata e të cilëve, edhe ashtu e vështirë, vetëm se u thellua. E gjithë kjo ka ndikim edhe afatshkurtër edhe afatgjatë mbi qytetarët dhe jetën e tyre, drejtpërsëdrejti dhe tërthorazi, si kushtet dhe mjedisi për jetë dhe punë.

Nga ana tjetër, krizat i dëmtuan demokracinë tashmë të brishtë si dhe shtetin e së drejtës, sepse kapacitetet e kufizuara të pushtetit qendror dhe pushtetit lokal ishin të fokusuar kryesisht në përballimin me situata të jashtëzakonshme. Duke ndërmarrë masa kryesisht ad hoc për ballafaqimin me krizat, autoritetet e harruan përgjegjësinë, llogaridhënien, transparencën, madje edhe informimin e publikut për efektet e krizës dhe të masave mbi qytetarët, jetën dhe punën e tyre, si dhe mbi të drejtat e tyre.

Politikat dhe masat të cilat i ndërmarrin pushteti qendror dhe pushteti lokal si përgjigje ndaj krizës financiare dhe energjetike (e cila manifestohet në inflacion dyshifror, çmime të larta të derivateve, rënie të vazhdueshme të standardit të jetesës së qytetarëve dhe stagnim të ekonomisë) pasqyrohen mbi buxhetet.

Organizatrat civile, si dhe qytetarët, nuk ishin mjaftueshëm aktivë në monitorimin e këtyre proceseve dhe rrjedhimisht, nuk janë identifikuar dobësitë konkrete të cilat lejojnë që interesi publik të jetë nën interesat politike dhe "blerjen e paqes" afatshkurtër

në lidhje me krizën ekonomike. Publiku informohet vetëm për aspektet e shpenzimeve buxhetore të cilat konsiderohen si relevante edhe nga bartësit e pushtetit qendror edhe nga bartësit e pushtetit lokal. Gjatë gjithë kësaj periudhe, jo vetëm që nuk u analizua dhe nuk u fol për problemin, por i njëjti madje u injorua me zhvillimet e reja politike në vend, të cilat, në një farë mënyre, i zhvendosën nga diskursi publik, çështjet thelbësore për të cilat projekti duhet të japë përgjigje. Domethënë, në vend që analizave, diskutimeve dhe aktiviteteve t'u shtohet çështja e ndikimit negativ nga krizat në jetën e njerëzve, temë dominuese ishte ndikimi i krizave në financat publike. Ndërkaq, narrativët si financat publike, huamarrjet, "vrimat" në buxhetet etj., vazhdojnë të jenë sikur diçka "e panjohur" dhe e largët për njerëzit kurse jo si diçka që lidhet drejtpërsëdrejti me qytetarët, jetën e tyre dhe (mos)realizimin e të drejtave të njeriut.

Së këtejmi, bëhet gjithnjë e më e nevojshme që të pikasen ato ndikime të njerëzit dhe të shërbejnë si një udhërrëfyes për veprim në rast të krizave të reja ose të vazhdimit të krizave aktuale. Prandaj, kjo analizë kishte për synim t'i detektojë fushat të cilat janë më së shumti të prekura nga kriza energjetike, përkatësisht ato fusha, në të cilat janë bërë shkurtime më të mëdha (të shpenzimeve) buxhetore për të mundësuar të mbulohen shpenzimet (pagesat) e rritura si pasojë e krizës. Pra, të zbulohet se si shpenzimet buxhetore të shtetit dhe të komunave për vitin 2022, të cilat janë ndryshuar nën ndikimin e krizës ekonomike (inflacion, stagnim dhe krizë energjetike), reflektohen te qytetarët, nëpërmjet hartëzimit të segmenteve ku gjenden mangësitë më të mëdha dhe përmes propozimit të masave të cilat duhet të mundësojnë që shpenzimet të jenë në interesin më të mirë të qytetarëve.

Metodologjikisht, të dhënat e nevojshme për hulumtimin dhe analizën janë mbledhur nga burime parësore (drejtpërsëdrejti nga institucionet e përfshira, faqet e tyre të internetit, intervista, si dhe përmes kërkesave për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik) dhe nga burime dytësore (nga institucione tjera, ueb-faqe, institucione ndërkombëtare, etj.). Klasifikimi dhe

përpunimi i të dhënave të mbledhura është bërë duke përdorur programe dhe aplikacione kompjuterike në mënyrë që të dhënat të jenë të përshtatshme për analizë cilësore. Analiza është bërë në mënyrë sasiore, nëpërmjet përpunimit matematikor të të dhënave numerike, si dhe në mënyrë cilësore, përmes analizës përshkruese dhe kontekstuale të gjendjes, shkaqeve dhe pasojave. Në fokus të hulumtimit janë buxhetet e shtetit dhe të komunave në të cilat janë paraqitur politikat dhe shpenzimet që janë planifikuar (buxheti i miratuar), ndikimi i krizës mbi të ardhurat dhe shpenzimet dhe si rrjedhojë, ndryshimet dhe amendimet në buxhetet (rebalans i buxhetit si dhe vendimet për rishpërndarje të mjeteve), si dhe ngjarjet reale dhe shkalla e realizimit të politikave, por edhe një prezantim i tërthortë e efekteve në jetën e qytetarëve (nëpërmjet realizimit të buxhetit, përkatësisht, llogarisë përfundimtare të buxhetit).


kWh



HULUMTIM I DETAJUAR NË PASOJAT NGA RITJJA E SHPENZIMEVE BUXHETORE NGA KRIZA NË VITIN 2022 NË FUSHAT TË CILAT NDIKOJNË NË JETËN E QYTETARËVE

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, fillimisht është miratuar me shpenzime të planifikuara në vlerë prej 284 miliardë denarë (4,6 miliardë euro). Me ndryshimet dhe plotësimet e buxhetit që u bënë në korrik të vitit 2022, shpenzimet janë zmadhuar për 5,73%, përkatësisht për 16 miliardë denarë (265 milionë euro). Pas rebalansit në korrik, gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2022, janë miratuar dy vendime për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve. Realizimi i buxhetit është 96,28% përkatësisht, në vlerë prej 291 miliardë denarë (4,7 miliardë euro).

Buxheti i RMV-së për vitin 2022 (në miliard euro)




Në nivel të zërave buxhetorë, rritjen më të madhe të shpenzimeve e kanë zërat buxhetorë 421 (Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport), 464 (Transfere të ndryshme), 471 (Kompensime sociale) dhe

485 (Investime dhe mjete jofinanciare). Të gjithë këta zëra buxhetorë, në fakt janë ndryshuar si pasojë e rritjes së kostove për energjinë elektrike dhe e masave që i ka ndërmarë Qeveria për zvogëlimin e pasojave nga kriza energjetike.

- Shpenzimet e zmadhuara nga zëri buxhetor 421 (Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport) janë në lidhje me rritjen e çmimeve të derivateve në vitin 2022. Këto shpenzime në vitin 2022 konsiderohet të jenë 108 milionë euro, që është 59 milionë më tepër se shpenzimet për të njëjtin dedikim në vitin 2021. Në vlerën totale të këtyre shpenzimeve, përveç shpenzimeve të paguara (sipas llogarisë përfundimtare të Buxhetit të RMV-së), përfshihen edhe detyrimet që janë maturuar mbi këtë bazë në vitin rrjedhës, por që nuk janë paguar. Së këtejmi, vlerësohet që janë paguar 83 milionë euro shpenzime, kurse 25 milionë janë maturuar por nuk janë paguara nga zëri buxhetor 421 (Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport).

Rritjen e shpenzimeve për energji më së miri e pasqyron zëri buxhetor 421 (Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport). Sipas këtij zëri, në vitin 2022 janë paguar gjithsej 5.104.225.873 denarë (82.995.543 euro), që është konsiderueshëm më tepër se shpenzimet në këtë zë buxhetor të vitit 2021, kur shuma kanë qenë 3.031.113.099 denarë (49.39.391 euro). Shpenzimet e paguara buxhetore në këtë bazë janë rritur për 68,4%, përkatësisht për 2.073.112.774 denarë (33.709.150 euro). Mirëpo, fotografia nuk është e plotë nëse ndalemi vetëm te këto të dhëna. Përkatësisht, sipas të dhënave të publikuara në faqen e Ministrisë së Financave për detyrimet e raportuara sipas llojit të shpenzimeve, rezulton se në vitin 2022, detyrimet e maturuara dhe të papaguara për zërin buxhetor 421 (Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport) janë të zmadhuara në raport me vitin 2021 për 1.567.444.134 denarë (25.486.896 euro).

Prezantim i zërit buxhetor 421 - Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport (në miliard euro)



Për nevojën, që në përlogaritjet e shpenzimeve për ngrohje të përfshihen edhe detyrimet e maturuara ndërkaq, të papaguara, flet edhe fakti që sipas të dhënave nga llogaria përfundimtare, në disa institucione, shpenzimet në zërin buxhetor 421 janë zmadhuar edhe deri në 70%, kurse në të tjera ka rritje shumë të vogla, madje edhe rënie të shpenzimeve. Kjo është skajshmërisht e palogjikshme duke e pasur parasysh rritjen e çmimeve të derivateve në vitin 2022. Nga këtu, për një përlogaritje reale të shpenzimeve në rritje, u imponua nevoja e përfshirjes së të dhënave për detyrimet e raportuara të institucioneve. Sipas këtyre të dhënave, detyrimet e papaguara në zërin buxhetor 421, në dhjetor të vitit 2021 kanë qenë 3.207.237.251 denarë (52.150.199 euro), ndërsa në vitin 2022, ato ishin 4.774.681.385 denarë (709.637 euro). Shuma e rritjes së këtyre shpenzimeve është 1.567.444.134 denarë (25486.896 euro) dhe ato janë përfshirë në përlogaritjen e shpenzimeve të përgjithshme të institucioneve për këtë dedikim.

- Mbështetja buxhetore për SHA Elektranat e Republikës së Maqedonisë së Veriut - ESM në vitin 2022, është 14 miliardë denarë, përkatësisht 230 milionë euro. Kjo mbështetje shkaktoi rritje të shpenzimeve nga zëri 464 (Transfere të ndryshme), por edhe të shpenzimeve kapitale nga zëri 485 (Investime dhe mjete jofinanciare) sepse një pjesë e mbështetjes është paguar edhe përmes zërit buxhetor 485580 (Aksione dhe kapital tjetër). Nëse kësaj shume i shtohet mbështetja buxhetore prej 86 milionë euro për të njëjtin dedikim, e cila i është paguar ESM-së në tremujorin e fundit të vitit 2021, si dhe 62 milionë euro të paguara nëntë muajt e parë të vitit 2023, rezulton se mbështetja totale e prodhimit vendas, si pasojë e krizës energjetike, është me vlerë prej 378 milionë euro. Nga programi për masat antikrizë, Qeveria ka bërë pagesa edhe për NP Pyjet Nacionale, SHA Ekonomi me Ujëra të RMV-së dhe SHA Posta, në vlerë totale prej 662.000.000 denarë (10.764.228 euro).

Përmes zërit buxhetor 464 (Transfere të ndryshme) SHA Elektrani i janë bërë 6 pagesa në vlerë totale prej 8.183.808.808 denarë (133.070.062 euro). Pagesat janë bërë në bazë të Vendimit për ekzistimin e gjendjes së krizës në furnizimin me energji termike (Gazeta Zyrtare e RMV-së numër 188/2022), ku qartë është cekur që do të ndërmerren masa dhe aktivitete në lidhje me sigurimin e sasive shtesë të energjisë termike në përputhje me situatën e krijuar të krizës. Pesë nga gjashtë pagesat janë nëpërmjet programit P1 (Masat për ballafaqim me krizën KOVID-19 dhe masa të tjera antikrizë), ndërsa vetëm një nga këto pagesa është nëpërmjet programit C5 (Zhvillim i blertë) në vlerë prej 10.9 milionë euro.

**Pagesat nga Qeveria për ESM-në nga zëri
buxhetor/konto 464990 – Transfere tjera**

Data	Programi	Shuma në denarë	Shuma në euro	Llogaria e SHA ESM në të cilën është bërë pagesa
18.1.2022	S5	670,000,000	10,894,308	Zë buxhetor i dedikuar për mbështetje buxhetore
21.1.2022	P1	360,000,000	5,853,658	Mbështetje buxhetore për furnizimin me energji termike
31.1.2022	P1	53,808,000	874,926	Zë buxhetor i dedikuar për mbështetje buxhetore
9.2.2022	P1	2,900,000,000	47,154,471	Zë buxhetor i dedikuar për mbështetje buxhetore
5.9.2022	P1	3,100,000,000	50,406,504	Zë buxhetor i dedikuar për mbështetje buxhetore
30.9.2022	P1	1,100,000,000	17,886,178	Mbështetje buxhetore për furnizimin me energji termike

Përmes zërit 485580 (Aksione dhe kapital tjetër), për SHA 'Elektrani' janë bërë edhe 6 pagesa në vlerë të përgjithshme prej 5.980.000.000 den (97.235.772 euro).

**Pagesa nga Qeveria për ESM nga zëri buxhetor/konto
485580 – Aksione dhe kapital tjetër**

Data	Programi	Shuma në denarë	Shuma në euro	Llogaria e SHA ESM në të cilën është bërë pagesa
21.1.2022	P1	615,000,000	10,000,000	Zë buxhetor i dedikuar për mbështetje buxhetore
17.2.2022	P1	665,000,000	10,813,008	Zë buxhetor i dedikuar për mbështetje buxhetore
30.11.2022	P1	800,000,000	13,008,130	Mbështetje buxhetore për furnizimin me energji termike
30.11.2022	P1	700,000,000	11,382,113	Zë buxhetor i dedikuar për mbështetje buxhetore
21.12.2022	P1	1,500,000,000	24,390,243	Zë buxhetor i dedikuar për mbështetje buxhetore
28.12.2022	P1	1,700,000,000	27,642,276	Zë buxhetor i dedikuar për mbështetje buxhetore

Pagesat nëpërmjet programit P1 për masat antikrizë në vitin 2022 janë bërë nga Qeveria dhe tre kompani tjera shtetërore, edhe atë ndaj NP Pyjet Kombëtare, SHA Ekonomi me Ujërat e RMV-së dhe SHA Posta në vlerë të përgjithshme prej 662.000.000 denarë (10.764.228 euro).

Paralelisht me përdorimin e një zëri të tillë për pagesën e mjeteve buxhetore duhet të ketë një llogari aktive për investim, domethënë një evidencë e tillë duhet

të përdoret për të zmadhuar kapitalin themelues të Qeverisë në ESM, që do të regjistrohet në regjistrin tregtar dhe në kapitalin bazë të kompanisë shtetërore. Evidentimi i llogarisë "Aksione dhe kapital tjetër" do të kishte kuptim vetëm nëse bëhet fjalë për investime të planifikuara afatgjata, e jo për sigurim të likuiditetit për mbulimin e shpenzimeve rrjedhëse për blerje të energjisë elektrike dhe energjisë termike.


Pagesat nga Qeveria ndaj ndërmarrjeve tjera nëpërmjet programit P1

Data	Programi	Marrësi	Llogaria	Shuma e denarit	Shuma euro
30.9.2022	P1	Pyjet Kombëtare të NP	464990	332,000,000	5,398,373
30.9.2022	P1	RSM Menaxhim me Ujëra SHA	464990	100,000,000	1,626,016
29.12.2022	P1	RSM Menaxhim me Ujëra SHA	485580	110,000,000	1,788,617
9/12/2022	P1	SHA Posta e Maqedonisë së Veriut	485580	50,000,000	813,008
21.12.2022	P1	SHA Posta e Maqedonisë së Veriut	485580	70,000,000	1,138,211

- Deri 28% të shpenzimeve kapitale të realizuara, përkatësisht 8 miliardë denarë (131 milion euro), janë shpenzuar për pagesa që nuk mund të klasifikohen në kategorinë "kapitale" dhe janë në lidhje të drejtpërdrejt apo të tërthortë me krizën energjetike. Bëhet fjalë për pagesat e Qeverisë ndaj SHA ESM dhe kompanive tjera shtetërore, si dhe për pagesat e garancive për kredi të kompanive shtetërore nga Ministria e Financave – funksione të shtetit. Në këtë mënyrë, krijohet një imazh joreal që një pjesë më e madhe e buxhetit e cila është përdorur për investime kapitale.

Shpenzimet kapitale të shtetit në vitin 2022 janë realizuar me shumën 28 miliardë denarë (465 milionë euro), që është rreth 10 miliardë denarë (163 milionë euro) më pak nga ajo që fillimisht ka qenë e planifikuar me Buxhetin e RMV-së, kur këto shpenzime kanë qenë të parapara në shumë prej 621 milion euro. Me realizimin e shpenzimeve buxhetore në vitin 2022 në shumë prej 28,6 miliardë denarë, përkatësisht 465 milionë euro, është arritur nivel rekord i lartë i shpenzimeve kapitale. Por, pas këtij trendi, i cili në dukje është pozitiv, fshehen shpenzime që nuk mund të cilësohen si kapitale dhe si të tilla kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Prezantim tabelor vjetor i llogarive sintetike nga grupi 48 - Shpenzime kapitale (në denarë);



Këqyrja në llogaritë sintetike të grupit 48 (Shpenzime kapitale) sugjeron se rritja më e madhe e shpenzimeve kapitale është realizuar, në fakt, përmes zërit buxhetor 485 (Investime dhe mjete jofinanciare). Përkundër kësaj, zërat 481 Objekte ndërtimore (ndërtimi i objekteve të reja dhe rikonstruktimi i ndërtesave banesore dhe afariste) dhe 482 Objekte tjera ndërtimore (rrugë urbane, rrugë, autostrada, ura, impiante trajtimi dhe kolektorë, deponi të mbeturinave, objekte për furnizim me ujë, mjete për energjetikë dhe ndërtimi i objekteve tjera) janë pothuaj në të njëjtin nivel për një periudhë pesëvjeçare. Më konkretisht, këta dy zëra arritën shumën 6,4 miliardë denarë (104 milionë euro) në vitin 2022, që është vetëm 1,81% më tepër se në vitin 2021..

Prezantim tabelor vjetor i llogarive sintetike nga grupi 48 – Shpenzime kapitale (në denarë);

Llogaria	2018	2019	2020	2021	2022
48 Shpenzime kapitale	12,146,473,832	17,812,576,221	16,114,683,918	23,407,879,779	28,637,112,919
480 Blerja e pajisjeve dhe makinerive	2,287,359,619	2,973,704,244	2,396,719,272	4,640,315,692	4,638,165,150
481 Objekte ndërtimore	304,662,972	528,725,327	527,413,753	896,927,546	726,987,804
482 Objekte tjera ndërtimore	5,463,604,361	5,014,633,125	4,457,740,586	5,389,523,241	5,673,397,308
483 Blerje e mobiljeve	99,617,820	114,636,229	57,273,506	125,745,745	83,439,297
484 Mallrat dhe rezervat strategjike	262,706,940	1,398,484,375	1,079,241,485	267,992,885	1,432,996,208
485 Investime dhe mjete jofinanciare	747,783,019	3,266,191,758	3,448,365,467	8,647,597,460	11,008,485,642
486 Blerje e mjeteve motorike	110,947,925	188,060,297	58,724,624	55,890,903	90,751,515
488 Grantet kapitale për NjVL-të	799,994,236	1,456,614,043	1,289,760,788	954,502,529	1,839,325,178
489 Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe OJQ-të	2,069,796,940	2,871,826,823	2,799,444,437	2,429,383,778	3,143,564,817

Rritja më e madhe në shpenzimet kapitale është realizuar përmes zërit buxhetor 485 (Investime dhe mjete jofinanciare), i cili arrin shumën 11 miliard denarë dhe përmes së cilit, në fakt, është zbatuar një pjesë e realizimit të mbështetjes për tejkalimin e krizës energjetike dhe janë bërë pagesa për SHA ESM (97 milionë euro), si dhe për kompani tjera shtetërore, SHA Posta (2 milionë euro) dhe SHA Ekonomi me Ujëra (1.8 milion euro). Mirëpo, nga ky zë buxhetor janë bërë pagesa edhe të Ministrisë së Financave - funksione të shtetit, për pagesat për garanci me këste për kreditë e SHA-së për Rrugë Shtetërore (24 milionë euro) dhe Hekurudhat e RMV-së Transport SHA, Shkup (6,3 milionë euro).

Sipas të dhënave të fituara nga Ministria e Financave – funksione të shtetit, rezulton se në vitin 2022 janë bërë pagesa nga zëri buxhetor 485 për garancitë e shtetit në përputhje me përcaktimet e kontratave të lidhura në rastet kur ndonjë ndërmarrje, për të cilën ka lëshuar garanci, nuk do të jetë në gjendje në ndonjë moment të paguajë detyrimet e saj për shlyerjen e kryegjësë dhe normës së interesit për ndonjë kredi. Siç mund të shihet nga prezantimi tabelor, në vitin 2022, Ministria e Financave ka pasur këtë lloj pagesash për kredi për SHA-në për Rrugë Shtetërore dhe Hekurudhat e RMV-së Transport SHA, Shkup.

Ky mekanizëm i evidentimit të pagesës së kryer në bazë të garancive shtetërore është i momentit dhe si i tillë nuk planifikohet paraprakisht në buxhet.

**Prezantim tabelor i pagesave të Ministrisë së
Financave – funksione të shtetit nga pika 485
-Investimet dhe asetet jofinanciare, për vitin 2022**

485 – Investime dhe mjete jofinanciare	Data	Vlera në denarë	Vlera në euro
Garanci e paguar për kryegjënë, interesin dhe provizionin e këstit të kredisë së NP-së për Rrugë Shtetërore	21.01.2022	930,461,968	15,129,463
Garanci e paguar për kryegjënë, interesin dhe provizionin e këstit të kredisë së Hekurudhat e RMV-së Transport SHA, Shkup.	21.03.2022	156,728,741	2,548,435
Garanci e paguar për kryegjënë, interesin dhe provizionin e këstit të kredisë së Hekurudhat e RMV-së Transport SHA Shkup.	19.04.2022	37,717,077	613,286
Garanci e paguar për kryegjënë, interesin dhe provizionin e këstit të kredisë së NP-së për Rrugë Shtetërore	21.07.2022	536,764,183	8,727,873
Garanci e paguar për kryegjënë, interesin dhe provizionin e këstit të kredisë së Hekurudhat e RMV-së Transport SHA, Shkup.	20.09.2022	156,925,967	2,551,642
Garanci e paguar për kryegjënë, interesin dhe provizionin e këstit të kredisë së Hekurudhat e RMV-së Transport SHA, Shkup.	17.10.2022	37,642,370	612,071

Burimi: Të dhënat nga Ministria e Financave sipas kërkesës për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik

Dhe së fundi, zmadhimi i zërit buxhetor 471 (Kompensime sociale) si pasojë e krizës energjetike rezulton nga Programi për Mbrojtjen e kategorive të lëndueshme të konsumatorëve të energjisë për vitin 2022. Sipas të dhënave të paraqitura në Llogarinë Përfundimtare për vitin 2022, masat e dedikuara për mbrojtjen e kategorive të lëndueshme të konsumatorëve janë realizuar me efekt fiskal prej 7 milionë euro.

- **Për mbulim të kostove që rriteshin prej krizës energjetike në vitin 2022 në buxhetin qendror të shtetit, si dhe në buxhetet komunale, u flijuan dhe pa realizim mbetën një sërë projektsh kapitale në vlerë prej së paku 220 milionë euro, të cilat përndryshe duhet të kishin kontribuar për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.**

Bëhet fjalë për objekte shëndetësore të pandërtuara dhe të pa rinovuara, shtëpi për të moshuar të pandërtuara, kopshte të pandërtuara, rrugë urbane dhe rrugë lokale të pandërtuara, rikonstruksione dhe renovime të porealizuara të objekteve shëndetësore, investime

të zvogëluara në arsim, investime të zvogëluara për përmirësimin e mjedisit jetësor, pajisje dhe makineri që nuk janë blerë (pajisje mjekësore, stacioni i monitorimit të cilësisë së ajrit, stacionet e filtrimit të hidrosistemeve, etj.).

Këtë e tregon analiza e thelluar e Buxhetit të vitit 2022, rebalansit të Buxhetit dhe Vendimet për rishpërndarjen e fondeve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve nga nëntori dhe dhjetori i vitit 2022, Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të vitit 2022, pastaj prokurimet publike të planifikuara dhe të realizuara të institucioneve për vitin 2022, si dhe të dhënat që janë siguruar përmes kërkesave për qasje tek informacionet me karakter publik, të dorëzuara në 18 institucione të nivelit qendror. Përzgjedhja e institucioneve të cilave u janë dorëzuar kërkesat është bërë pas një analize paraprake të të dhënave nga e cila rezultoi që ndryshimet më të mëdha në zërat përkatës buxhetorë janë bërë pikërisht te këto institucione, qoftë në lidhje me rënien e shpenzimeve kapitale të planifikuara fillimisht, apo lidhur me shpenzime tjera.

Realizimi i disa prej këtyre projekteve është transferuar në vitin 2023, ndërsa një pjesë humbin nga planet e prokurimeve publike të institucioneve në nivel qendror dhe në nivel lokal. Duke e pasur parasysh praktikën e institucioneve për t'i paguar borxhet e papaguara nga buxheti aktual dhe për të bartur pagesat për projektet aktuale në vitin e ardhshëm, do të ishte e pamundur të vlerësohet me saktësi vlera e projekteve dhe aktiviteteteve të planifikuara që mbetën të porealizuara po të ngelnim vetëm në analizat e dokumenteve institucionale që janë në dispozicion për publikun. Pra, një pjesë e madhe e të dhënave janë siguruar në mënyrë plotësuese edhe nga vetë institucionet, në të cilat është vërejtur dallimi më i madh buxhetor në planifikim dhe realizim.


Pikërisht mungesa e qasjes tek informacionet me karakter publik për aktivitetet e planifikuara dhe shkallën e realizimit të tyre e imponon nevojën për instalimin e një sistemi të plotë përlllogaritës të raportimit financiar në vend të raportimit aktual të bazuar mbi para të gatshme. Komunat raportojnë për aktivitetet e tyre të planifikuara dhe të realizuara përmes raporteve të publikuara tremujore dhe vjetore të miratuara nga Këshillat.

Situata sipas sektorëve ndarazi, të cilët ndikojnë më së shumti në jetën e qytetarëve është si më poshtë:

Në SHËNDETËSI - më së shumti mjete janë shkurtuar nga rindërtimi dhe zgjerimi i objekteve shëndetësore, për çka fillimisht është paraparë të shpenzohen 875 milionë denarë, përkatësisht 14 milionë euro, mirëpo janë shpenzuar vetëm 216 milionë denarë, përkatësisht 3,5 milionë euro.

Gjatë vitit 2022, në sektorin e shëndetësisë, zërat buxhetorë nga programet për rikonstruktimin dhe zgjerimin e objekteve të institucioneve publike shëndetësore, për ndërtimin e spitalit të përgjithshëm në Kërçovë dhe për ndërtimin e qendrës së re klinike në Shkup dhe në Shtip. Nga 14 milionë euro fillimisht të planifikuara, janë shpenzuar vetëm 3.5 milionë euro.

Rikonstruktim dhe zgjerim i objekteve shëndetësore në vitin 2022 (milion denarë)



Për tre nënprogramet - rikonstruktimi dhe zgjerimi i objekteve të institucioneve publike shëndetësore, ndërtimi i spitalit të përgjithshëm në Kërçovë dhe ndërtimi i qendrës së re klinike në Shkup dhe në Shtip, në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut të vitit 2022 janë planifikuar gjithsej 874.670.000 denarë (14.222.276 euro).

Me miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të buxhetit për vitin 2022, mjetet janë shkurtuar për 59,54%, përkatësisht për 520.769.000 denarë (8.467.789 euro). Nga niveli i nënprogrameve që janë paraqitur në pasqyrën tabelore, shkurtimi më i madh është bërë te mjetet e dedikuara për ndërtimin e qendrës së re klinike në Shkup dhe të asaj në Shtip, edhe atë për 77,30%, ndërsa në dy programet tjera shkurtimi është 29,27%, për rikonstruktimin dhe zgjerimin të objekteve të institucioneve publike shëndetësore dhe 26,25%, për ndërtimin e spitalit të përgjithshëm në Kërçovë.

Pas kësaj, vijojnë edhe shkurtime të reja në mjetet buxhetore të dedikuara për këto tre nënprograme të Ministrisë së Shëndetësisë, edhe atë me dy vendime për rishpërndarjen e fondeve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, të cilat janë miratuar në muajt nëntor dhe dhjetor 2022.

Me miratimin e dy Vendimeve nga ana e Kuvendit të RMV-së, vlera e këtyre tre nënprogrameve është zvogëluar për 68.658.724 denarë (1.116.402 euro), përkatësisht për 19,40%. Më pas, edhe me këtë shkurtim të mjeteve në këto tre nënprograme, shuma e ngelur prej 285.242.276 denarë (4.638.086 euro) nuk është realizuar në tërësi, por vetëm deri 215.928.603 denarë (3.511.034 euro), që është vetëm 24,30% e shumës fillimisht të planifikuar me Buxhetin e RMV-së për vitin 2022.

Nënprogramet e Ministrisë së Shëndetësisë me shkurtimet më të mëdha për vitin 2022 (në denarë)

Nënprogrami	Buxheti për vitin 2022	Rebalans i buxhetit për vitin 2022	Vlera pas 2 rishpërndarjeve të mjeteve	Realizimi
1A – Rikonstruksioni dhe zgjerimi i objekteve të ISHP në RMV	259,670,000	183,651,000	150,744,276	117,366,570
1E – Spitali i Përgjithshëm Kërçovë	60,000,000	44,250,000	39,130,000	28,451,169
Ndërtimi i qendrës së re klinike në Shkup dhe në Shtip	555,000,000	126,000,000	95,368,000	70,110,864
Gjithsej në denarë	874,670,000	353,901,000	285,242,276	215,928,603
Gjithsej në euro	14,222,276	5,754,488	4,638,086	3,511,034

Për të siguruar më tepër informacione, vijoi një analizë në Planin për Prokurime Publike në vitin 2022, nga e cila rezultoi se për **rikonstruktimin dhe zgjerimin e objekteve shëndetësore publike** kanë qenë të planifikuara projektet e mëposhtme:

- Rikonstruktimi dhe renovimi i KARMI;
- Performanca dhe përshtatja e ISHP HOPS Oteshevë;
- Rikonstruksioni dhe adaptim e sallave operative për nevojat e ISHP KU për kirurgji digjestive;
- Rikonstruksioni dhe adaptim e ISHP KU për dermatovenerologji;
- Rikonstruksioni dhe zgjerim i ISHP Klinika për Sëmundje Kirurgjike "Shën Naum Ohridski" Shkup;

- Erazmo - Ohër realizim dhe zgjerimi i sallës së pestë operative dhe instalimi i ashensorëve;
- Restaurimi i fasadës dhe drugdhendjes për fasadë (kryerje e punëve ndërtimore, projektim dhe revidim si dhe mbikëqyrje profesionale) - Klinika të brendshme dhe
- Ndërtimi dhe instalim i ASHENSORIT për nevojat e ISHP KU për Hematologji.

Bëhet fjalë për projekte, realizimi i të cilave ka qenë i prolonguar në të kaluarën. Projektet janë planifikuar të realizohen në vitin 2023 dhe janë pjesë e Planit aktual për Prokurime Publike të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2023. Megjithatë, që nga korriku i vitit 2023, nuk është nisur procedurë e prokurimit publik për asnjë nga këto objekte.

Statusi i projekteve për rikonstruksionin dhe zgjerimin e objekteve të institucioneve shëndetësore publike

Lënda	Fillim i planifikuar i procedurës në vitin 2023	Statusi në korrik të vitit 2023
Rikonstruksioni dhe renovimi i KARIL – Klinika e anesteziës, reanimacionit dhe mjekimit intensiv	shkurt	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik
Realizim dhe adaptim për ISHP HOPS Oteshevë	shkurt	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik
Rikonstruksioni dhe adaptimi i sallave operative për nevojat e ISHP KU për kirurgji digjестive	shkurt	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik
Rikonstruksioni dhe përshtatja e ISHP KU për dermatovenerologji	shkurt	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik
Rikonstruksioni dhe zgjerimi i ISHP Klinika për Sëmundje Kirurgjike “Shën Naum Ohridski” Shkup	shkurt	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik
ISHP Spitali Special për Ortopedi dhe Traumatologji “Shën Erazmo” – Ohër, Ndërtimi dhe zgjerimi i Sallës së Pestë Operative dhe instalimi i ashensorëve	mars	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik
Restaurimi i fasadës dhe drugdhendjes për fasadë, punime ndërtimi - Klinika të brendshme	mars	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik
Restaurimi i fasadës dhe drugdhendjes për fasadë dhe revizion – Klinika të brendshme	mars	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik
Restaurimi i fasadës dhe drugdhendjes për fasadë, kryerje e mbikëqyrjes profesionale - Klinika të brendshme	mars	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik
Ndërtimi dhe instalimi i ASHENSORIT për nevojat e ISHP KU për Hematologji	prill	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik

Për efektet negative nga kjo qasje e shkurtimit të shpenzimeve buxhetore, konkretisht nga këta zëra flasin të dhënat për numrin e pacientëve të cilët i shfrytëzojnë shërbimet e këtyre institucioneve shëndetësore. Sipas të dhënave të Institutit të Shëndetit Publik, Klinikat Interne, në nivel vjetor kanë 180.000 vizita nga pacientë, Klinikat për Dermatovenerologji rreth 75.000 vizita, Erazmo - Ohër 34.000 vizita nga pacientë etj.

Investimet e zvogëluara në shëndetësi reflektohen edhe në buxhetin e Ministrisë së Financave, më konkretisht në zërin buxhetor 482 (Objekte tjera ndërtimore), ku ka qenë e paraparë të shpenzohen 161.000.000 denarë (2.617.886 euro) të dedikuara për rikonstruktimin e objekteve shëndetësore në kuadër të Projektit për efikasitet energjetik, për çka janë siguruar mjetet në vlerë totale prej 25 milionë euro me kredi nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore. Ministria e Financave konfirmoi që me rebalansin e buxhetit, vlera e mjeteve për rikonstruktimin e objekteve shëndetësore është shkurtuar nga 161.000.000 denarë (2.617.886 euro) në 20.000.000 denarë (325.203 euro) dhe se këto mjete janë ridedikuar për konton e zërit buxhetor 485 (Kredi të komunave) në lartësi prej 50.000.000 denarë (813.008 euro) me qëllim të shfrytëzimit më të madh të shpenzimeve kapitale. Ministria e Financave nuk ka dhënë sqarime për vonesën në rikonstruktimin e planifikuar të objekteve shëndetësore.

Në fushën e MBROJTJES SOCIALE, në vitin 2022 nuk janë realizuar dhe as nuk është filluar realizimi i 7 projekteve ndërtimore me vlerë 342.598.121 denarë (5.507.701 euro) të dedikuara për të moshuarit, për personat me pengesa dhe për fëmijët në kopshtet për fëmijë.

Më konkretisht, bëhet fjalë për ndërtimin e Shtëpisë së të Moshuarve në Komunën e Koçanit, punimet për ndërtimin e Qendrës Ditore për personat me pengesa mendore dhe fizike në Komunën e Kavadarit, punime ndërtimore për adaptimin dhe ridedikimin e Shtëpisë për foshnje dhe fëmijë të vegjël në kopsht në Komunën e Manastirit, ndërtimi i objektit për kopsht për fëmijë në Komunën e Manastirit, zgjerime të kopshteve për fëmijë në komunat Dellçevë dhe Dibër, si dhe zgjerimi i objektit ekzistues "Kokiçe" në Komunën Karbinci, fshati Tarinci. Disa nga këto projekte mbase kanë qenë të planifikuara edhe si projekte shumëvjeçare.

Ministria për Punë dhe Politikë Sociale ka dorëzuar informata për këtë listë të objekteve që është dashur të realizohen por nuk janë realizuar në zërin buxhetor 481 (Objekte ndërtimore) të Buxhetit për vitin 2022. Mirëpo, ata thonë se nga 7 projekte, do të vazhdojnë me 5 dhe që nuk dihet fati i vetëm dy objekteve, edhe atë ndërtimi i kopshtit për fëmijë në Komunën e Manastirit dhe punimet ndërtimore për objektin e Shtëpisë për të moshuar në Komunën e Koçanit.

Shkaqet për anulimin e disa prej projekteve nuk janë dhënë. Njëkohësisht, analiza e të dhënave në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike sugjeron që nga pesë projektet, vazhdimi i të cilave është paralajmëruar, vetëm për realizimin e punimeve ndërtimore për adaptim dhe ridedikim të Shtëpisë për foshnje dhe fëmijë në kopsht në Komunën e Manastirit, është lidhur kontrata në vitin 2023, ndërsa për realizimin e punimeve ndërtimore për objektin e kopshtit të fëmijëve në Komunën e Dellçevës është publikuar shpallje. Për tre projektet tjera mbetet e pasigurt nëse do të realizohen këtë vit.

**Statusi i projekteve të Ministrisë
për Punë dhe Politikë Sociale**


Objekti	Shuma në denarë	Fillimi i planifikuar i procedurës për vitin 2023	Statusi në korrik 2023
Kryerja e punimeve ndërtimore për zgjerimin e objektit të kopshtit për fëmijë në Komunën e Dibrës	7,400,000	prill 2023	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik
Kryerja e punëve ndërtimore për ndërtimin e kopshtit për fëmijë në Komunën e Dellçevës	43,330,383	prill 2023	Procedura me numër 06567/2023 është në rrjedhë
Kryerja e punëve ndërtimore për zgjerimin e objektit ekzistues "Kokiçe" në Komunën e Karbincit, fshati Tarinci	13,993,028	mars 2023	Nuk është publikuar shpallje për prokurim publik
Kryerja e punimeve ndërtimore për adaptimin dhe ridedikimin e Shtëpisë për foshnje dhe fëmijë të vegjël në kopshtin për fëmijë në Komunën e Manastirit.	10,536,656	shkurt 2023	Kontratë e lidhur në qershor 2023
Kryerja e punëve ndërtimore për ndërtimin e objektit të kopshtit për fëmijë në komunën e Manastirit, faza ndërtimore - zeytari.	20,033,900	Nuk është pjesë e PVPP 2023	/
Kryerja e punëve ndërtimore për ndërtimin e Shtëpisë për persona të moshuar në Komunën e Koçanit	213,649,374	Nuk është pjesë e PVPP 2023	/
Kryerja e punimeve ndërtimore për ndërtimin e Qendrës ditore për personat me pengesa mendore dhe fizike në Komunën e Kavadarit.	33,654,780	Është bartë në PVPP 2023	Nuk është publikuar asnjë njoftim për prokurim publik

Si rezultat i proceseve të lartpërmendura, në Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit për vitin 2022, në lidhje me programet e Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, shkurtimet më të mëdha vërehen në programin 3A (Ndërtim, furnizim me pajisje dhe mirëmbajtje e objekteve për mbrojtje fëmimore), në të cilën, nga


shuma prej 152.035.000 denarë (2472.114 euro) fillimisht e planifikuar, pas rebalansit dhe vendimeve për ridedikim, është bërë shkurtim për 59,39% dhe kanë ngelur 61.748.111 denarë (1.004.023 euro), ndërsa realizimi të jetë vetëm deri në 44 465. 029 denarë (723 009 euro).

NDRYSHIME NË PROGRAMET E MINISTRISË PËR PUNË DHE POLITIKË SOCIALE

Programi 3A – Ndërtim, pajisje dhe mirëmbajtje e objekteve për mbrojtje të fëmijëve në vitin 2022 (milion denarë)



Programi 4A – Ndërtim, pajisje dhe mirëmbajtje e objekteve për mbrojtje sociale dhe shtëpi për persona të moshuar në vitin 2022 (milion denarë)



Sipas llogarisë përfundimtare për vitin 2022, te Ministria për Punë dhe Politikë Sociale është vërejtur realizim i dobët i zërit buxhetor 480 (Blerje pajisje dhe makineri). Bëhet fjalë për një zë buxhetor, i cili fillimisht ka qenë i planifikuar me shumën 269.400.000 denarë (4.380.488 euro), ndërsa me rebalansin është bërë rritje në shumë prej 431.761.442 denarë (7.020.511 euro). Megjithatë, realizimi i këtij zëri buxhetor është vetëm 3,6%, përkatësisht është realizuar në shumë modeste prej 15.564.668 denarë (253.084 euro).

Sqarimi i Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale lidhur me zërin buxhetor 480 (Blerje e pajisjeve dhe makinerive) për vitin 2022 është që pjesa më e madhe e pajisjeve të cilat janë blerë janë nga programi P1 (Masat për ballafaqim me krizën e KOVID-19 dhe masat tjera antikrizë) dhe se pajisjet e planifikuara janë blerë, por nuk janë paguar plotësisht në vitin 2022, përkatësisht, shumica e pagesave do të bëhen në vitin 2023. Gjatë kësaj, Ministria thotë se: "Në pajtim me kërkesën dhe pëlqimin, të parashtruar nga Banka Botërore, data e përfundimit të projektit është prolonguar deri më 30.12.2022 me afat pagese 4 mujore, përkatësisht deri më 30.04.2023. Sipas kësaj, me rebalansin e buxhetit janë kërkuar më tepër mjete për blerjen e pajisjeve mjekësore për nevojat e institucioneve mjekësore në shtet. Blerja e pajisjeve mjekësore ka përfunduar në tetor të vitit 2022 dhe është paguar një paradhënie për pajisjen mjekësore në përputhje me marrëveshjet e lidhura me Philips Medical Systems Nederland B.V dhe Siemens Healthcare GmbH."

Pagesat nga zëri buxhetor 480 – Blerje e pajisjeve dhe makinerive, të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale të cilat janë bartur në vitin 2023

Lëndë e kontratës		Data e kontratës	Autoriteti kontraktues	Realizimi (pagesa në denarë) 2023
Prokurim, livrim dhe instalim i pajisjeve për zgjerimin e objektit IPK KF "Goce Dellçev" "Sërniçka" në Komunën e Probishtipit.	Pjesa 4 – këndi i lojërave në të hapur	17.10.2022	Kiro Llend Trejd SHPKPV Shkup	555,072
Blerje, livrim dhe instalim i pajisjeve mjekësore për nevojat e: Spitalit Klinik në Tetovë, Spitalit Klinik në Manastir, Spitalit Klinik në Kumanovë, Spitalit të Përgjithshëm në Strumicë, Spitalit të Specializuar për Parandalim, Mjekim dhe Rehabilitim për Sëmundje Sardiiovaskulare - Ohër, SPQ "8 Shtatori", KU për Sëmundje Kirurgjike "Shën Naum Ohridski", KU për Radiologji	Azurion 7 B20 Clarity Azurion 5 C12 Clarity DigitalDiagnostics t C50 ClearVue 850 (Urologji) ClearVue 850 (Kardiologji) ClearVue 850 (Gjinekologji dhe Obstetrikë) ClearVue 850 (Bark dhe Tiroide) Eqiq CVx ClearVue 850 (Radiologji)	14.10.2022	Philips Medical Systems Nederland BV	148,455,441
Blerje, livrim dhe instalim i pajisjeve mjekësore për nevojat e: SK në Shtip, KU për Kardiologji, QU për Kardiokirurgji, SPQ "8 Shtatori", SK Tetovë, Kirurgjia Universitare "Shën Naum Ohridski", KU për Neurologji, SP Kumanovë, KU për Radiologji, SP Strumicë, SP Strugë, SP me aktivitet të zgjeruar Dibër.	MAMMOGRAPHY SYSTEM – Mammomat Revelation MAMMOGRAPHY SYSTEM – Mammomat InspirationCT SKANER 128 – Somatom go. TopC-ARM SYSTEM – Cios Select wANGIOGRAPHIC SYSTEM – Artis QANGIOGRAPHIC SYSTEM Montuar në dysHEME, për procedura intervenueze kardiovaskulare dhe elektrofiziologji – Artis IconoANGIOGRAPHIC SYSTEM Montuar në dysHEME, për procedura kardiovaskulare intervenueze – Artis one	28.10.2022	Siemens Healthcare GmbH	355,564,902


Investimet në ARSIM pothuaj janë përgjysmuar në vitin 2022 dhe nga 1,2 miliard denarë të buxhetuara fillimisht, përkatësisht 20 milionë euro, janë realizuar vetëm 10 milionë euro.

Më të prekur kanë qenë projektet e planifikuara për konviktet e studentëve. Nënprogramet “Ndërtimi i shkollave të mesme” dhe “Ndërtimi dhe rikonstruktimi i konvikteve për nxënës” janë reduktuar në zero, ndërkaq, shkurtimet më të mëdha buxhetore, por edhe dështime në realizim, kanë ndodhur në nënprogramin “Rehabilitimi për efikasitet energjetik i konvikteve studentore”.

Buxheti për vitin 2022 është miratuar me projektimin që në arsim të investohen 1.241.059.000 denarë (20.179.821 euro), edhe atë për ndërtim të shkollave fillore, rikonstruktim të shkollave fillore, ndërtim të sallave sportive në shkollat fillore, ndërtim të shkollave të mesme, për rikonstruktimin e shkollave të mesme, ndërtim të sallave sportive në shkollat e mesme, për ndërtimin dhe rikonstruktimin e konvikteve studentore dhe për rehabilitim për efikasitet energjetik të konvikteve studentore.

Zvogëlimi i parë i shumës së investimeve në sferën e arsimit është bërë me Ndryshimet dhe plotësimet e Buxhetit për vitin 2022, edhe atë në lartësi prej 19,88%, përkatësisht për 246.646.000 denarë (4.010.504 euro), ndërsa vlera e investimeve është paraparë në shumën 994.413.000 denarë (16.169.317 euro). Pas kësaj, vijnë edhe shkurtimet të reja në mjetet buxhetore të dedikuara për investime në arsim, edhe atë me dy vendimet për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, të cilat janë miratuar në nëntor dhe dhjetor të vitit 2022. Me miratimin e këtyre Vendimeve në Kuvendin e RMV-së, shuma e investimeve në arsim është zvogëluar në mënyrë plotësuese për 26,92%, përkatësisht për 267.716.043 denarë (4.353.106 euro) dhe ka arritur shumën 726.696.957 denarë (11.816 euro). Kështu, mjetet buxhetore për investime në arsim gjithsej janë zvogëluar për 514.362.043 denarë (8.363.610 euro).

Investime në arsim në vitin 2022 (milion denarë)




Siç shihet nga prezantimi tabelor i ndryshimeve dhe realizimit të nënprogrameve nga të cilat përbëhet programi “Investime në arsim”, nënprogramet “Ndërtim i shkollave të mesme” dhe “Ndërtim dhe rikonstruktimi i konvikteve studentore” janë zvogëluar në zero, ndërsa shkurtimet më të mëdha buxhetore, por edhe dështimet në realizim kanë ndodhur në nënprogramin “Rehabilitim për efikasitet energjetik i konvikteve studentore”.

Programi - Investime në arsim i Ministrisë për Arsim dhe Shkencë për vitin 2022 (në denarë)

Nënprograme për Investime në arsim	Buxheti për vitin 2022	Rebalansi i buxhetit për vitin 2022	Vlera pas 2 shpërndarjeve të mjeteve	Realizimi
TA – Ndërtimi i shkollave fillore	92,000,000	92,000,000	80,526,828	73,479,002
TB – Rikonstruktimi i shkollave fillore	293,000,000	293,000,000	249,810,000	232,991,941
Ndërtimi i sallave sportive shkollore në shkollat fillore	399,090,000	288,368,000	242,019,536	184,433,709
Ndërtimi i shkollave të mesme	700,000	700,000	0	0
TD – Rikonstruktimi i shkollave të mesme	86,500,000	86,500,000	56,683,233	56,250,526
Ndërtimi i sallave sportive shkollore në shkollat e mesme	1,550,000	3,350,000	3,290,486	3,290,486
Ndërtimi dhe rikonstruktimi i konvikteve studentore	25,000,000	25,000,000	0	0
Rehabilitimi për efikasitet energjetik i konvikteve studentore	343,219,000	205,495,000	94,366,874	59,287,604
Gjithsej në denarë	1,241,059,000	994,413,000	726,696,957	609,733,268
Gjithsej në euro	20,179,821	16,169,317	11,816,211	9,914,362

Lidhur me anulimet buxhetore gjatë vitit 2022 në sektorin e arsimit, vlen të përmenden edhe shkurtimeve e konstatuara në zërin buxhetor 480 (Blerje e pajisjeve dhe makinerive). Nga analiza e bërë në këtë zë buxhetor konstatohet që me Buxhetin për vitin 2022, ky zë buxhetor ka qenë i projektuar me 511.145.000 denarë (8.311.300 euro), që më pas, me rebalansin ajo shumë të zvogëlohet në 354.675.000 denarë (5.767.073 euro), e më pas me vendimin për rishpërndarjen e mjeteve është zmadhuar pak, me shumë prej 375.751.801 denarë (6.109.785 euro) dhe në fund, është realizuar në shumë prej 295.492.701 denarë (4.804.759 euro).

Mjete për blerje të pajisjeve në arsim për vitin 2022 (milion denarë)



Ministria për Arsim dhe Shkencë, në lidhje me listën e kërkuar për pajisjet dhe makineritë të cilat janë paraparë për prokurim, e që nuk janë prokuruar me shkurtimin e shumës fillimisht të planifikuar buxhetore, ka dorëzuar një listë, vlera financiare e së cilës nuk përputhet me të dhënat nga Buxheti i RMV-së për vitin 2022 dhe me Llogarinë Përfundimtare për vitin 2022, por është konsiderueshëm më e vogël.

Prezantim i zërit buxhetor 480 – Blerje e pajisjeve dhe makinerive në vitin 2022, nga MASH (në denarë)

Nënprogram	Buxheti	Rebalansi	Buxheti pas Vendimit dhe ridedikimit të mjeteve	Realizimi deri më 31.12.2022
10 – Administrata	2,000,000	2,000,000	622,977	85,956
14 – Agjencia për Cilësi në Arsimin e Lartë	140,000	140,000	49,000	46,260
16 – Këshilli Kombëtar për Arsim të Lartë	400,000	400,000	40,000	0
20 – Arsimi fillor	720,000	720,000	720,000	570,830
21 – Projektet për arsim fillor	25,000,000	23,150,000	15,169,068	12,361,208
30 – Arsimi i mesëm	1,600,000	1,600,000	1,043,743	825,890
33 – Qendra për Arsimin e të Rriturve	150,000	150,000	52,000	52,000
40 – Arsimi i lartë			265,500	225,453
41 – Universiteti i Shën Cirili dhe Metodi	10,000,000	10,000,000	10,000,000	9,866,805
42 – Universiteti i Shën Klementi i Ohrit	1,500,000	1,500,000	1,500,000	1,500,000
43 – Universiteti i Tetovës	1,500,000	1,500,000	1,500,000	1,500,000
44 – Universiteti Goce Delçev Shtip	3,000,000	3,000,000	3,000,000	2,424,677
45 – Universiteti Nënë Tereza	15,000,000	15,000,000	6,017,462	4,545,062
46 – Universiteti për Teknologji Informatike në Ohër	200,000	200,000	200,000	199,860
50 – Standardi i nxënësve	6,000,000	6,000,000	0	0
60 – Standardi studentor	44,000,000	44,000,000	2,600,000	0
72 – Institutet shkencore	3,500,000	2,800,000	1,985,051	1,700,801
TV – Ndërtimi i sallave sportive në shkollat fillore	130,000	130,000	0	0
Shuma totale në denarë	114,840,000	112,290,000	44,818,801	35,904,802
Shuma totale në euro	1,867,317	1,825,853	729,249	583,818

Programi PËRMIRËSIM I MJEDISIT JETËSOR, i cili në vitin 2022 fillimisht ishte i buxhetuar me rreth 1,9 miliard denarë,


përkatësisht 30 milionë euro, ndërkaq është realizuar me shumë prej vetëm 13 milionë euro, edhe atë më së shumti me transferim të mjeteve nga Qeveria në SHA-në 'Elektranat e Maqedonisë së Veriut' për realizimin e projektit të centraleve fotovoltaike Oslomej.

Programi për përmirësimin e mjedisit jetësor përbëhet nga dy nënprograme, edhe atë nënprogrami S1 (Përmirësimi i mjedisit jetësor), të cilin e zbaton Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor dhe nënprogrami S5 (Zhvillimi i blertë), i cili zbatohet nëpërmjet Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë.


Në total, programi për përmirësimin e mjedisit jetësor në Buxhetin e RMV-së për vitin 2022 ishte i projektuar me shumë 1.882.706.000 denarë (30.613.105 euro). Me rebalansin e Buxhetit, mjetet janë shkurtuar për 329.750.000 denarë (5.361.788 euro), që është për 17,51%. Me rishpërndarjet e mjeteve për këtë zë buxhetor, vlera është zmadhuar vetëm minimalisht për 1.306.500 denarë (21.243 euro). Mirëpo, problemi shfaqet në realizimin e këtij programi, ku, nga shuma totale e planifikuar prej 1.554.262.500 denarë (25.272.561 euro), realizohen vetëm 823.983.949 denarë (13.398.112 euro). Gjatë kësaj, përqindja e realizimit të nënprogramit "Përmirësimi i mjedisit jetësor" është 82,63%, ndërsa realizimi i nënprogramit shumë më të madh "Zhvillimi i blertë" është 53,01%. Sipas të dhënave nga Thesari, pjesën më të madhe të mjeteve nga nënprogrami për Zhvillim të blertë, Qeveria e ka transferuar në ESM, edhe atë 670.000.000 denarë (10.894.309 euro), ndërsa pjesa tjetër janë transfere në llogaritë jorezidente. Sipas informacioneve të publikuara, transferi në EMV është për zbatimin e projektit për centralet fotovoltaike Oslomej, i përgatitur në përputhje me Strategjinë e Qeverisë për Zhvillimin e Energjetikës deri në vitin 2040, e bazuar në Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane.

NËNPROGRAMI PËR PËRMIRËSIMIN E MJEDISIT JETËSOR NË VITIN 2022 (NË DENARË)

Nënprogrami S1 – Avancim i Mjedisit Jetësor (e zbaton MMJPH) në vitin 2022 (milion denarë)



Nënprogrami S5 – Zhvillim i blertë (e zbaton Qeveria) në vitin 2022 (milion denarë)



Ndryshime të mëdha në buxhetin e Ministrisë për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor për vitin 2022 janë vërejtur edhe në zërat buxhetor 480 (Blerje e pajisjeve dhe makinerive) dhe 482 (Objekte tjera ndërtimore). Gjatë kësaj, në zërin buxhetor të dedikuar për blerje të pajisjeve dhe makinerive është vërejtur zvogëlim i shumës nga 68.460.000 denarë në vetëm 17.720.000 denarë. Nga Ministria kanë sqaruar që ndryshimi është për shkak të tre pikave në vazhdim:

1. Prokurimi i pjesëve rezervë për hidrosistemin për liqenin e Dojranit është anuluar për shkak se sistemi nuk ka pasur nevojë për pjesë rezervë.
2. Nga dy stacionet e planifikuara monitoruese (20.000.000 denarë) është blerë vetëm një, në vlerë prej 8.340.000 denarë, për faktin se kanë marrë informacion nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 02-1824/1 nga 11.03.2022 që janë ndërmarrë masa ekonomike për ballafaqim me krizën energjetike dhe krizën me çmimet. Pjesa tjetër e mjeteve janë kthyer në buxhetin qendror me rebalansin.
3. Blerja e teknologjisë për paketim dhe ambalazhim të mbeturinave në vlerë prej 37.200.000 denarë nga zëri buxhetor 480 (Blerje e pajisjeve dhe makinerive) është bartur në pikën 488 (Dotacione kapitale për NjVL-të), kështu që është realizuar plotësisht.

Nga përgjigja e tillë, bëhet e qartë se kriza ekonomike ka ndikuar në ndryshimet e bëra me zvogëlim të numrit të stacioneve të blera për monitorim. Gjithashtu është e paqartë, pse është bërë bartja e mjeteve nga zëri buxhetor 480 në 488.

Nga ana tjetër, realizimi i zërit buxhetor 482 (Objekte tjera ndërtimore), tregon se një pjesë e madhe e projekteve që duhet të kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit jetësor nuk e kanë dinamikën e dëshiruar. Përkatësisht, dallimi nga planifikimi deri në realizim në vlerë prej 411.378.000 denarë (6.689.073 euro) është shpjeguar si vonesë e projekteve, por jo edhe anulim i tyre.

kWh



Prezantim i zërit buxhetor 482 – Objekte tjera ndërtimore të Ministrisë për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor në vitin 2022

Programi	Zëri buxhetor	Lokacioni	Përshkrim	Shuma e planifikuar	Realizimi	Pjesa që ka mbetur	Statusi i projekteve
23	Menaxhimi dhe mbrojtja e ujit	Berovë	Rehabilitimi i sistemit të ujësjellësit me stacion filtrues në komunën e Berovës me vlerë përgjithshme projekti prej 75.967.390 denarë [prokurim publik shumëvjeçar 2022-2024]	7,500,000	0	7,500,000	Marrëveshja e nënshkruar më 23.12.2022. Realizimi i projektit është në rrjedhë.
		Bogdanci	Rikonstruktimi i rrjetit të ujësjellësit në Bogdanci, me vlerë projekti prej 257.897.084 denarë [prokurim publik shumëvjeçar 2022-2025]	12,878,000	0	12,878,000	Marrëveshja e nënshkruar më 29.12.2022. Realizimi i projektit është në rrjedhë.
25	Trajtimi i ujërave të zeza	Dojrani	Rikonstruktim/ Ndërtim i kolektorit dhe impiantit për trajtim në Dojran	5,000,000	0	5,000,000	Në vitin 2022 kemi pasur një prokurim publik të pasuksesshëm për shkak të ofertave të papranueshme. Me vendim të Qeverisë, në vitin 2022, në llogari të dedikuar nga zëri buxhetor 488 janë transferuar mjete me shumë prej 65 milionë denarë.
			Mbikëqyrje teknike profesionale e projektit "Rinstruktimi i kolektorit dhe impiantit për trajtim në Dojran"				
		Haraçinë	Rregullimi i kanalit në Haraçinë (prokurim publik shumëvjeçar 2022 - 2024)	7,000,000	0	7,000,000	Në vitin 2022 kemi pasur një prokurim publik të pasuksesshëm për shkak të ofertave të papranueshme. Në vitin 2023 është nisur një procedurë e re e cila është në fazën e vlerësimit të ofertave.
		Gazi Baba	Ndërtimi i kanalizimit fekal në Straçinci, komuna Gazi Babë [prokurim publik shumëvjeçar 2022-2023]	10,000,000	0	10,000,000	Marrëveshja e nënshkruar më 12.12.2022. Realizimi i projektit është në rrjedhë.

25	Trajtimi i ujërave të zeza	Ligji për ngarkim me borxh të Republikës së Maqedonisë së Veriut me kredi në Bankën Evropiane për Investime sipas marrëveshjes financiare për projektin "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Shkup".	369,000,000	0	369,000,000	Me rebalansin e fundit, mjetet e parapara për këtë zë buxhetor janë zvogëluar në shumën 289.000.000 den.
----	----------------------------	--	-------------	---	-------------	--


Në fushën e BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE EKONOMISË ME UJËRA, është e rëndësishme të veçohen dy zëra buxhetorë që duhet të kenë kontribuar në përmirësimin e situatës në këtë fushë, kurse ato janë nënprogramet 6A (Hidrosistemi Zletovicë) dhe 1A (Modernizimi i bujqësisë), ku ka pasur shkurtim të mjeteve. Nga 282 milionë denarë, përkatësisht 4,5 milionë euro fillimisht të planifikuara, për këto nënprograme janë shpenzuar vetëm 64 milionë denarë, apo pak më shumë se 1 milion euro.

Në Buxhetin për vitin 2022, për nënprogramin Hidrosistemi Zletovicë, fillimisht të planifikuara kanë qenë 214.281.000 denarë (3.484.243 euro). Me rebalansin e buxhetit, mjetet janë zvogëluar për 28,15%, përkatësisht për 60.330.000 denarë (980.976 euro) dhe kanë ngelur 153.951.000 denarë (2.503.268 euro). Po ashtu, me vendimet për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe fondeve të miratuara në Kuvendin e RMV-së, mjetet janë shkurtuar për 90.352.263 denarë shtesë (1.469.142 euro) dhe ka ngelur shuma 63.598.737 denarë. Përqindja e realizimit të mjeteve kështu të zvogëluara, siç mund të shihet edhe nga prezantimi grafik më poshtë, është e lartë.


Sa i përket nënprogramit për modernizim të bujqësisë, nga shuma 68.180.000 denarë (1.108.618 euro), fillimisht e planifikuar, me rebalansin e Buxhetit për vitin 2022, mjetet janë zvogëluar për 31,82% dhe kanë ngelur 42.900.610 denarë (1.108.618 euro). Prej tyre, janë realizuar vetëm 2.258.727 denarë (36.727 euro), përkatësisht 5,26%.

NËNPROGRAMET E MINISTRISË PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE EKONOMI ME UJËRA PËR VITIN 2022, ME SHKURTIMET MË TË MËDHA

Nënprogrami për Hidrosistemin Zletovica në vitin 2022 (milion denarë)



Nënprogrami për modernizim në bujqësi në vitin 2022 (milion denarë)



Në përgjigjen për nivelin e ulët të realizimit të zërit buxhetor 480 (Blerje e pajisjeve dhe makinerive) nga Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujëra, nuk e lidhin nivelin e ulët të realizimit me krizën ekonomike, por me problemet të cilat i kanë pasur me zbatimin e procedurave të tenderit. Në përgjigjen e tyre thuhet: "Realizimi i buxhetit të MBPEU-së për vitin 2022, në Programin 6A (HS Zletovicë), zëri buxhetor 480 (Blerje e pajisjeve dhe makinerive) në pozicionet 2, 3, 4 dhe 5 (të cilat janë paraqitur në tabelën më poshtë) nuk u përmbush sepse prioritet i është dhënë ndërtimit të Stacionit të Filtrimit në Shën Nikole (Pozicioni 2). Për një kohë të gjatë përgatitej dokumentacioni i tenderit për realizim, por fatkeqësisht shpallja publike u anulua në fund të vitit 2022 dhe më pas nuk kishte kohë për të realizuar një shpallje të re. Për këto arsye, MBPEU-ja ishte e qëndrimit që realizimin e këtij programi ta përmbushë NP Hidrosistemi Zletovicë dhe janë ndërprerë aktivitetet e mëtutjeshme lidhur me shpalljen e prokurimeve publike për nënzërat tjerë të zërit buxhetor 480".

kWh



Programi 6A – Hidrosistemi Zletovicë, zëri buxhetor 480
– Blerje e pajisjeve dhe makinerive nga Buxheti i MBPEU-së për vitin 2022.

Nr.r.	Përshkrim	Buxheti	Rebalansi	Realizimi	Sqarim i arsyeve për zvogëlimin dhe mosrealizimin e pozicioneve konkrete
1	Përmirësimi i HS Zletovica (SCADA) në NP HS Zletovicë – Probishtip	9,532,500	9,532,500	1,321,622	Projekti është i bashkëfinancuar me donacion nga QBZHN nga R. e Sllovenisë dhe përbëhet nga dy pjesë, pjesa elektro dhe mekanike. Arsyeja për realizimin më të vogël është për shkak të nënshkrimit të Marrëveshjes për Donacion më 05.05.2022, e jo në fillim të vitit dhe për shkak të anulimit të prokurimit publik të parë, për pjesën e mekanikës. Për këto arsye, realizuesit i është bërë vetëm pagesë e faturës paradhënie për pjesën 1 të projektit. Projekti me siguri do të realizohet në vitin 2023.

2	Ndërtimi i Stacionit të Filtrave UV 100 l/s me mbikëqyrje në Shën Nikole	105,575,500	66,560,500		Realizimi i buxhetit të MBPEU-së për vitin 2022, në Programin 6A – HS Zletovicë, zëri buxhetor 480 – Blerje e pajisjeve dhe makinerive në pozicionet 2, 3, 4, dhe 5 nuk është realizuar për shkak se prioriteti është dhënë ndërtimit të Stacionit të Filtrimit në Shën Nikole (Pozicioni 2). Një kohë më të gjatë është përgatitur dokumentacioni i tenderit për realizim, mirëpo për fat të keq, shpallja publike u anulua në fund të vitit 2022 dhe më pas nuk kishte kohë për të realizuar një shpallje të re. Për këto arsye, MBPEU-ja ishte e qëndrimit që realizimin e këtij programi ta përmbush NP HS Zletovicë dhe u ndërpreu aktivitetet e mëtutjeshme lidhur me shpalljen e prokurimeve publike nga nënzërat tjerë të zërit buxhetor 480.
3	Blerja, transporti dhe instalimi i Agregatit me naftë 110 kVA në stacionin e filtrimit në Karbinci	1,500,000	1,500,000		
4	Përgatitja e projektit bazë për stacionin filtrues për Llozovë	500,000	500,000		
5	Përmirësimi i furnizimit me ujë të Zonës së Epërme në Probishtip me mbikëqyrje	6,000,000	6,000,000		
Gjithsej në denarë		123,108,000	84,093,000	1,321,622	

Për problemet në buxhet tregon edhe rezultati i programit 60 (Programi i Ekonomisë me Ujëra) për vitin 2022. Për këtë program, në buxhet nuk janë paraparë mjete, që më pas, me rebalansin të alokohen 18.956.000 denarë. Lidhur me informatat e kërkuara nga Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi me Ujëra, është dhënë sqarimi si vijon: "Ministria e Financave pas tremujorit të tretë të vitit 2022 ka shkurtuar mjete nga zëri buxhetor 480 në vlerë prej 12,327,250 denarë dhe ato janë bartur në llogarinë 414480 (Rezerva kapitale, blerje pajisjesh), me ç'rast, në këtë zëri buxhetor, kah fundi i muajit tetor ngelin 6.637.750 denarë. Nga këto mjete, Me Vendimin për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë dhe fondeve, të miratuar në Kuvendin e RMV-së [Gazeta Zyrtare e RMV-së 232/22] është tërhequr një shumë prej 6.637.000 denarë nga llogaria 480 dhe gjendja përfundimtare në fund të vitit, në këtë bilanc është 750 denarë. Në pajtim me programin për ekonomi me ujëra për vitin 2022 [Gazeta Zyrtare e RMV-së numër 36/22, 141/22, 188/22 dhe 273/22] dhe me Programin Vjetor të Investimeve për vitin 2022 të SHA-së Ekonomia me Ujëra të Republikës së Maqedonisë së Veriut (që janë miratuar në mbledhjet e Qeverisë më 12.04.2022 dhe 23.08.2022),

janë paraparë mjete për pagesë të detyrimeve nga kontratat e lidhura në vitin 2021 për blerje të mekanizimit, si dhe mjete për realizimin e një prokurimi publik të ri në vitin 2022 për blerje e mekanizimit për SHA-në Ekonomi me Ujëra. Detyrimet nga kontratat e lidhura nga viti 2021 janë paguar në tërësi, ndërsa pagesa e faturës për mekanizimin e blerë të SHA Ekonomisë me Ujëra gjatë vitit 2022 është kryer me Buxhetin për vitin 2023 për shkak të mungesës së mjeteve në llogarinë 480 (e shpjeguar paraprakisht).

Investimet në INFRASTRUKTURËN RRUGORE, me Buxhetin për vitin 2022, fillimisht kanë qenë të projektuara në 5,9 miliardë denarë (96 milionë euro), që më pas të pezullohen tërësisht, ndërsa zvogëlim të mjeteve ka pasur edhe për projektet për ujësjellës dhe kullimin e ujërave të zeza.

Me Buxhetin për vitin 2023, në Ministrinë për Transport dhe Lidhje janë zvogëluar tre programe, 2M (Investime në infrastrukturën rrugore), 3G (Projektet për furnizim me ujë dhe për kullimin e ujërave të zeza) dhe 3L (Ndërtim i sistemit për furnizim me ujë – Sopishtë). Gjatë kësaj, më i madhi është programi për investime

në infrastrukturën rrugore, i cili përfshinte ndërtimin infrastrukturor Korridorin 8 (Segmenti: Tetovë - Gostivar - Bukoçan dhe autostradën Trebenishtë - Strugë - Qafë Thanë) dhe Korridorin 10 (Segmenti i autostradës Prilep - Manastir) dhe në të ishin projektuar mjete me shumën 5.938.874.000 denarë (96.567.057 euro). Me rebalansin e buxhetit të vitit 2022, mjetet për këtë program u zvogëluan për 37,95% dhe ishin paraparë me shumën 3.685.000.000 denarë (59.918.699 euro). Pastaj, me vendimet për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, mjetet financiare janë tërhequr krejtësisht. Ky anulim është për shkak të përgatitjeve për zbatimin e marrëveshjes së lidhur me konsorciumin "Bechtel dhe Enka".

Programi tjetër i rëndësishëm nga Ministria për Transport dhe Lidhje është programi i cili përfshin Projekte për furnizim me ujë dhe për kullimin e ujërave të zeza, program i cili fillimisht ishte i projektuar me

vlere prej 448.210.000 denarë (7.287.967 euro), pastaj me rebalansin dhe me vendimet për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, ajo shumë të zvogëlohet për 45% në shumën 246.518.000 denarë (4.008.423 euro). Megjithatë, edhe me këtë përqindje të zvogëlimit, mjetet nuk janë realizuar tërësisht, por në shumën 178.831.617 denarë (2.907.831 euro).

Programi i radhës, i cili iu nënshtrua shkurtimeve është programi për Ndërtim të sistemit për furnizim me ujë - Sopishtë, i planifikuar me shumë 20.000.000 denarë (325.203 euro), i cili më pas me vendimet për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, është shfuqizuar tërësisht.

Programe të Ministrisë për Transport dhe Lidhje për vitin 2022 me shkurtime më të mëdha (në denarë)

Programi	Buxheti për vitin 2022	Rebalansi i buxhetit për vitin 2022	Vlera pas 2 vendimeve për rishpërndarje të mjeteve	Realizimi
2M – Investime në infrastrukturën rrugore	5,938,874,000	3,685,000,000	0	0
3G – Projektet për furnizim me ujë dhe për kullimin e ujërave të zeza	448,210,000	267,850,000	246,518,000	178,831,617
3L – Ndërtimi i sistemit për furnizim me ujë – Sopishtë	20,000,000	20,000,000	0	0

Përkundër këtyre shkurtimeve të mëdha, me rebalansin e Buxhetit të vitit 2022, në zërin buxhetor 489 (Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare) është shtuar Programi për ndërtim të banesave sociale, i cili nuk ka qenë i paraparë në buxhetin fillimisht të miratuar për vitin 2022. Ndërtimi ka qenë i planifikuar me shumë prej 200.000.000 denarë (3.252.032 euro) dhe ka qenë tërësisht i realizuar.

Prokurimi dhe vendosja e sinjalistikës në vendkalimet hekurudhore në vlerë prej 51 milion denarë, përkatësisht 839 mijë euro, është projekti më i madh që është përjashtuar nga plani i prokurimeve nga Ministria e Financave - funksione të shtetit. Por, ajo që është shqetësuese është se për një pjesë të konsiderueshme të projekteve të cilat duhet t'i ketë të realizuar Ministria, ndërsa kryesisht janë fituar nga mjetet e programit IPA të Bashkimit Evropian, përqindja e realizimit ka qenë jashtëzakonisht e vogël, vetëm 37.78%. Bëhet fjalë për zërat buxhetorë 480 (Blerje e pajisjeve dhe makinerive) dhe 482 (Objekte tjera ndërtimore), për të cilat është planifikuar realizim i projekteve në vlerë prej 1.839.286.224 denarë¹ [29.907.093 euro], ndërkaq janë realizuar vetëm 694.849.941 denarë [11.298.373 euro].

Shikuar nga aspekti i projekteve të planifikuara por të porealizuara të Ministrisë së Financave - funksione të shtetit, të cilat janë të rëndësishme për cilësinë e jetës së qytetarëve, mund ta veçojmë projektin e anuluar për prokurim dhe vendosje të sinjalistikës në vendkalimet hekurudhore në vlerë prej 51.620.800 denarë [839.363 euro] nga zëri buxhetor 482, si dhe përgatitja e planifikuar e dokumentacionit të projektit për përmirësimin e infrastrukturës për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza dhe rrjeti i ujësjellësit në Komunën e Haraçinës, në vlerë prej 7.145.600 denarë [116.188 euro], që po ashtu është përjashtuar nga plani i Ministrisë.

Megjithatë, përjashtimi i këtyre dy projekteve të rëndësishme është i shoqëruar edhe me nivel shumë të dobët të realizimit të mjeteve për projektet e miratuara nga programi IPA i Bashkimit Evropian. Siç mund të shihet nga prezantimi tabelor, në vitin 2022 ka qenë e planifikuar të realizohen projekte në vlerë të përgjithshme prej 1.839.286.224 denarë [29.907.093 euro], të cilat, kryesisht janë nga fondet IPA të BE-së. Mirëpo, për shkak të vonësës së procedurave të tenderit, si dhe për shkak të dinamikës së dobët të realizimit të kontratave të lidhura, janë realizuar projekte në vlerë prej vetëm 694.849.941 denarë [11.298.373 euro].

¹ Mjetet e planifikuara të marra me kredi nga BEI në vlerë prej 67.000.000 denarë janë përjashtuar nga shuma e përgjithshme, duke pasur parasysh se fatura e dorëzuar për mbikëqyrjen e kontratës për rindërtimin dhe përmirësimin e autostradës Demir Kapi - Smokvicë është pranuar në shumë më të vogël [63.197.850 denarë] se sa ishte planifikuar dhe kontrata ishte mbyllur në shumë më të vogël.

kWh



Pagesat e planifikuara dhe të realizuara në vitin 2022

Ministria e Financave – funksione të shtetit

Nënprogrami ME Transporti dhe mjedisi jetësor	Shuma e planifikuar	Pagesa të realizuara	Dallimi	Arsyetimi
Mjedisi Jetësor				
Blerje e pajisjeve TI dhe i pajisjeve tjera specifike për monitorimin e mjedisit jetësor dhe e sistemit për informacione	24.640.000	0	24,640,000	Kontrata nuk u nënshkrua për shkak se procedura e tenderit ishte në rrjedhë
Blerje e pajisjeve teknike dhe për zyre dhe e softuerit TIK për strukturën operative të MMJPH për zbatimin e SOPECA 2014-2020	4.435.200	0	4,435,200	Kontrata nuk u nënshkrua për shkak se procedura e tenderit ishte në rrjedhë
Blerje e pajisjeve specifike për sistemin informativ për monitorim të ujit	17.248.000	0	17,248,000	Kontrata nuk u nënshkrua për shkak se procedura e tenderit ishte në rrjedhë
Mbikëqyrje e realizimit të kontratave të punës për përmirësimin e infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të zeza në Qytetin e Shkupit	15.612.960	9596895	6,016,065	Janë dorëzuar më pak situata të përkohshme nga ato që fillimisht ishin planifikuar për vitin 2022
Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Kërçovës	214.060.610	0	214,060,610	Kontrata nuk u nënshkrua për shkak se procedura e tenderit ishte në rrjedhë
Mbikëqyrja e kontratës për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit në Komunën e Kërçovës	7.736.553	7.736.553	0	E paguar sipas buxhetit të planifikuar
Mbikëqyrja e kontratës për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza si dhe rehabilitimin dhe përmirësimin e rrjetit të kanalizimit në Komunën e Manastirit	16.016.010	0	16,016,010	Kontrata nuk u nënshkrua për shkak se procedura e tenderit ishte në rrjedhë
Mbikëqyrja e kontratës për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza si dhe rehabilitimin dhe përmirësimin e rrjetit të kanalizimit në Komunën e Tetovës.	18.480.010	0	18,480,010	Kontrata nuk u nënshkrua për shkak se procedura e tenderit ishte në rrjedhë
Zhvillimi i dokumentacionit të projektit për përmirësimin e infrastrukturës për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza dhe rrjetin e ujësjellësit në Komunën e Haraçinës.	7.145.600	0	7,145,600	Projekti është përjashtuar nga plani për prokurime publike


Mbyllja e deponive të parregulluara dhe e deponive të egra në rajonin lindor – Llot 1	203,899,740	51,213,589	152,686,151	Plani ka qenë të paguhen dy fatura (paradhënie dhe faturë e përkohshme), kontraktori ka parashtruar kërkesë vetëm për paradhënie
Kontratë për mbikëqyrjen e punimeve ndërtimore për mbylljen e deponive dhe deponive të egra në rajonet lindore dhe verilindore – Faza e parë	11,567,453	7,317,027	4,250,426	Plani ka qenë të paguhen dy fatura (paradhënie dhe faturë e përkohshme), kontraktori ka parashtruar kërkesë vetëm për paradhënie
Transporti				
Ndërtimi i aksit rrugor Gradsko – nyja Drenovë si pjesë e korridorit rrugor X-d	861,852,920	327,816,914	534,036,005	Janë dorëzuar më pak situata të përkohshme nga ato që fillimisht ishin planifikuar për vitin 2022
Mbikëqyrje e ndërtimit të aksit rrugor Gradsko – nyja Drenovë si pjesë e korridorit rrugor X-d	51,893,960	66,141,398	-14,247,438	Janë dërguar raporte financiare që mbulojnë periudhën e viteve 2021 dhe 2022 dhe për këtë arsye janë paguar më shumë mjete nga shuma fillimisht e planifikuar
Rehabilitimi i rrugës shtetërore A2, pjesa Kumanovë - Stracin (faza 1)	185,568,690	107,775,162	77,793,527	Janë dorëzuar më pak situata të përkohshme nga ato që fillimisht ishin planifikuar për vitin 2022
Mbikëqyrja e rehabilitimit të rrugës shtetërore A2, segmenti Kumanovë - Stracin (faza 1)	16,583,535	24,784,207	-8,200,672	Janë dërguar raporte financiare që mbulojnë periudhën e viteve 2021 dhe 2022 dhe për këtë arsye janë paguar më shumë mjete nga shuma fillimisht e planifikuar
Asistencë teknike për zbatimin e projektit për zëvendësimin e gardheve mbrojtëse sipas standardeve EN në segmentet prioritare të identifikuara përgjatë autostradës së Korridorit X	59,800	0	59,800	Projekti është përjashtuar nga plani për prokurime publike
Blerje dhe vendosje e sinjalistikës në vendkalimet hekurudhore	51,620,800	0	51,620,800	Projekti është përjashtuar nga plani për prokurime publike
Asistencë teknike për furnizimin dhe vendosjen e sinjalistikës në nivelet e vendkalimeve hekurudhore	2,199,120	0	2,199,120	Projekti është përjashtuar nga plani për prokurime publike

Nënprogrami ME – Drejtësi dhe Punë të Brendshme				
Nënprogrami ME – Drejtësi dhe Punë të Brendshme	1.323.358	1.323.358	0	Платено согласно планиран Вухети
Набавка на опрема за имплементација на деловен континуитет и систем за обновување на катастрофи и модернизација на ИТ инфраструктурата во седиштето на МВР	40.933.240	40.933.240	0	Платено согласно планиран Вухети
Nënprogrami ME – Arsimi dhe Punësimi				
Ndërtimi i kopshtit për fëmijë në komunën e Tetovës, LIOT 1	34,726,341	23,440,522	11,285,819	Më pak shpenzime janë raportuar për punimet e përfunduara ndërtimore
Ndërtimi i kopshtit për fëmijë në komunën e Tearcës LIOT 2	34,850,623	20,054,089	14,796,534	Më pak shpenzime janë raportuar për punimet e përfunduara ndërtimore
Mbikëqyrje e kontratës për ndërtim - Ndërtimi i kopshteve për fëmijë në komunën Tetovë dhe komunën Tearcë	52,910	0	52,910	Kontraktuesi nuk ka parashtruar raport/kërkesë financiar/e për pagesë
Blerje e pajisjeve - Mbështetje e plotësuese për zbatimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	16,778,791	6,716,987	10,061,804	Në vend që në tremujorin e katërt të vitit 2022, fatura është paguar në vitin 2023
GJITHSEJ NË DENAR	1,839,286,224	694,849,941	1,144,436,281	
GJITHSEJ NË EURO	29,907,093	11,298,373	18,608,720	

Shkurtim i madh i mjeteve është evidentuar edhe në REFORMAT NË INSTITUCIONET NDËSHKIMORE-KORRIGJUESE. Kjo është e rëndësishme të theksohet, duke e pasur parasysh që një nga problemet kryesore në realizimin e të drejtave themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të drejtat e personave të cilët gjenden në entet ndëshkimore-korrigjuese, për çka sugjerojnë Avokati i Popullit, organizatat joqeveritare të përfshira, si dhe raportet e institucioneve ndërkombëtare sikur Stejt Departamenti i SHBA-së dhe Këshilli i Evropës.

Në Buxhetin e RMV-së për vitin 2022, nënprogrami Reforma në ENK ka qenë i paraparë me shumë 283.801.000 denarë (4.614.650 euro). Me rebalansin e Buxhetit, mjetet për këtë nënprogram janë zvogëluar për 51,1% dhe janë projektuar me shumën 138.747.000 denarë (2.256.049 euro). Një shkurtim shtesë prej 13,42% është bërë me vendimet për rishpërndarjen e mjeteve dhe ato janë zvogëluar në shumën 120.123.086 denarë (1.953.221 euro). Por, edhe nga kjo shumë e mjeteve të zvogëluara, realizimi është vetëm 6,50%, përkatësisht janë realizuar 7.807.114 denarë (126.945 euro).

**Nënprogrami – Reforma në Entet
Ndëshkimore-Korrigjuese të Drejtorisë për
Ekzekutimin e Sanksioneve për vitin 2022
(milion denarë)**



Sipas të dhënave nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, lista e objekteve dhe projekteve të përealizuara që kanë qenë pjesë e zërit buxhetor 481 (Objekte ndërtimore) është e gjatë dhe ajo përfshin një sërë nismash shumëvjeçare të cilat kanë mbetur pa u filluar në vitin 2022. Më i vlefshmi ndër to është projekti për ndërtimin e objekteve në Njësinë Qendrore të Shërbimit, Reparti i Paraburgimit dhe Reparti i Mbyllur në INK Idrizovë, me vlerë të përllogaritur prej 1.979.134.846 denarë (32.181.054 euro), që padyshim është një projekt shumëvjeçar i cili duhet të ketë filluar të realizohet në vitin 2022.

Projektet e përealizuara të Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve nga nënprogrami 3B – Reformat në institucionet ndëshkimore-korrigjuese si pjesë e zërit buxhetor 481 – Objekte ndërtimore për vitin 2022

Objektet/projektet e planifikuara dhe të përealizuara, në vitin 2022	Vendndodhja e objektit	Vlera totale (në denarë)
1. Rikonstruktimi i nënstacioneve dhe i stacionit të pompës në INK Idrizovë	INK Idrizovë	30,680,000
2. Ndërtimi i drenazhit të ujërave atmosferike në INK Idrizovë deri në lumin Vardar	INK Idrizovë	12,744,000
3. Ndërtimi i objekteve në Njësinë Qendrore të Shërbimit, Reparti i Paraburgimit dhe Reparti i Mbyllur në INK Idrizovë (Segmenti 2)	INK Idrizovë	1,979,134,846
4. Mbikëqyrje profesionale mbi rikonstruktimin e nënstacioneve dhe stacioneve të pompës në INK Idrizovë	INK Idrizovë	920,400
5. Mbikëqyrje profesionale e ndërtimit të drenazhit të ujërave atmosferik në INK Idrizovë deri në lumin Vardar.	INK Idrizovë	382,320
6. Mbikëqyrje profesionale mbi ndërtimin e objekteve në INK Idrizovë - Njësia Qendrore e Shërbimit, Reparti i Paraburgimit dhe Reparti i Mbyllur dhe Infrastruktura (Segmenti 2)	INK Idrizovë	79,165,421

Pa realizim kanë mbetur edhe planet për RENOVIMIN E AMBASADAVE, PËRFAQËSIVE KONSULLORE DHE REZIDENCAVE të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Brazilia, Kanberë, Athinë, Budapest, Zyrih dhe Harare.

Dallimet e detektuar nga planifikimi i objekteve kapitale të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe realizimi i tyre shpiten në informacionin që ky institucion, në përputhje

me planet për vitin 2022, duhej të kishte realizuar 7 projekte të rëndësishme, përkatësisht objekte të cilat do të kapnin vlerën totale prej 246,150,000 denarë (4.002.439 euro), kurse në vitin 2022 do të ishin realizuar në vlerë prej 130.000.000 denarë (2.113.821 euro). Projektet janë prezantuar në tabelën më poshtë, ku shihet se 6 nga shtatë projektet janë prolonguar për në vitin 2024.

Projektet e planifikuara për realizimin e zërit buxhetor 481 – Objekte ndërtimore nga Ministria e Punëve të Jashtme për vitin 2022 (në denarë)

Përshkrimi i pjesëve të buxhetit	Buxheti i miratuar për realizimin e projektit në vitin 2022	Vlera e tërë projektit	Prolongim
Prokurimi i punimeve ndërtimore për rinovimin dhe adaptimin e një objekti të fituar nga trashëgimia në pronësi të RMV-së në Brazilia për dedikim afarist-rezidencial për nevojat e Ambasadës së RMV-së në Brazilia (ambasadë dhe apartament për punonjës).	27,000,000	27,000,000	Aktivitetet për vitin 2024 janë prolonguar për shkak të kryesimit të RMV-së me OSBE-në
Përgatitje e dokumentacionit të projektit – projekti bazë dhe prokurimi i punimeve ndërtimore për rinovimin dhe adaptimin e objektit të fituar nga trashëgimia në pronësi të RMV-së në Kanberë ekskluzivisht për qëllime banimi që lejohet me rregullore urbanistike (rezidencë dhe banesa për diplomatë).	14,000,000	20,000,000	Aktivitetet e prolonguara për në vitin 2024
Përgatitje e dokumentacionit të projektit - projekti bazë dhe prokurimi i punimeve ndërtimore për rinovim me rehabilitim statik të objektit të fituar nga trashëgimi në pronësi të RMV-së në Athinë me zgjerim dhe zgjerim, për qëllime afarizmi-banimi për nevojat e PDK-së të RMV-së në Athinë (ambasadë, rezidencë dhe 2 banesa për punonjës).	23,000,000	73,000,000	Aktivitetet e prolonguara për në vitin 2024
Përgatitje e dokumentacionit të projektit - projekti bazë dhe prokurimi i punëve ndërtimore për rikonstrukcionin statik të objektit të Ambasadës RMV-së në Budapest në pronësi të RMV-së, me zgjerim dhe përmirësim me dedikim afarist-rezidencial për nevojat e PDK-së të RMV-së në Budapest (ambasadë, rezidencë dhe 2 banesa për punonjës).	31,000,000	91,150,000	Aktivitetet e prolonguara për në vitin 2024

Prokurimi i punimeve ndërtimore për renovimin e objektit në Zyrih të fituar nga trashëgimia e RSFJ-së në pronësi të RMV-së, për nevojat e Përfaqësisë konsullore (konsullata dhe 2 banesa për punonjës).	27,000,000	27,000,000	Realizimi i punimeve është prolonguar për vitin 2023 për shkak të vazhdimet të lejes ndërtimore
Prokurimi i draft-projektit dhe projektit kryesor për ndryshimin e projektit ekzistues për ndërtimin e një objekti të ri për PDK të RMV-së në Ankara në parcelë nën pronësi të RMV-së	3,000,000	3,000,000	Aktivitetet e prolonguara për në vitin 2024
Prokurimi i punimeve ndërtimore për rehabilitimin bazë të objektit të trashëguar nga RSFJ në pronësi të RMV-së në Harare	5,000,000	5,000,000	Aktivitetet për në vitin 2024 janë prolonguar për shkak të regjistrimit të pronësisë së objektit në kadastër.

Ndër objektet të cilat kanë ngelur pa realizim është edhe rikonstruktimi i terracës në objektin e MPJ-së me vlerë prej 12.000.000 denarë (195.122 euro). Realizimi, siç njoftojnë nga Ministria e Punëve të Jashtme, është shtyrë për vitin 2023, me një zgjidhje të ndryshuar për ndërtimin e tendës me vendosjen e paneleve fotovoltaike.

Në vitin 2022 nuk janë blerë as PAJISJET TI të planifikuara për Drejtorinë e të Ardhurave Publike (DAP), as nuk është bërë përmirësim i pajisjeve ekzistuese dhe konsolidimi i bazave të të dhënave në vlerë prej 49.000.000 denarë, përkatësisht rreth 800 mijë euro. Kjo është e rëndësishme për qytetarët, nëse merrret parasysht konstatimi i Entit Shtetëror për Revizion, në revizionin e kryer të suksesit, që dizajni i vendosur i sistemeve të informacionit për menaxhimin me detyrimet publike në DAP nuk siguron në tërësi menaxhim efikas dhe të qëndrueshëm me procesin e administrimit të detyrimeve publike.

Në vitin 2022, Drejtoria e të Ardhurave Publike mbeti pa blerjen e pajisjeve të reja të TI-së, por edhe pa rinovimet e planifikuara të objekteve të institucionit.

Sa i përket blerjes së pajisjeve, me Buxhetin për vitin 2022 fillimisht ka qenë e planifikuar që DAP të shpenzojë 49.000.000 denarë (796.748 euro) për këtë dedikim, me rebalansin, shuma e mjeteve u zvogëlua në 17.763.660 denarë (288.840 euro), e më pas, nga ajo shumë të realizohen vetëm 622.659 denarë për blerje të pajisjeve për ngrohje dhe klimatizim 613.660 denarë dhe për pajisje për kuzhinë në vlerë prej 8.999 denarë.

Pa realizim, siç mund të shihet nga prezantimi tabelor, ka ngelur konsolidimi i stacioneve të punës dhe pajisjeve periferike - blerja e pajisjeve të TI-së, pastaj ngritja e kapacitetit për qarkullim të pajisjeve dhe shërbimeve për komunikime dhe konsolidimi i bazave të të dhënave për sistemet ekzistuese të TI-së/nënsistemet në një bazë të dhënash të vetme për futjen e ESB për 'Data exchange' dhe instalimin e një 'Data Warehouse' dhe licencat për softuer të sistemit dhe bazat e të dhënave (hardware).

Pajisjet e Drejtorisë për të Ardhura Publike që nuk janë blerë në vitin 2022

Zërat buxhetorë	Vlera në denarë
Konsolidimi i stacioneve të punës dhe i pajisjeve periferike – Blerja e pajisjeve TI	28,000,000
Rritja e kapacitetit për qarkullim të pajisjeve dhe shërbimeve për komunikime	13,000,000
Konsolidimi i bazave të të dhënave për sistemet/nënsistemet ekzistuese të TI-së në një bazë të dhënash të vetme për futjen e ESB për 'Data exchange'dhe instalimin e një 'Data Warehouse' dhe licencat për softuerin e sistemit dhe bazat e të dhënave (hardware)	8,000,000

Pa realizim ka ngelur edhe renovimi i objekteve të Drejtorisë për të Ardhura Publike, për çka fillimisht ka qenë e planifikuar të shpenzohen 45.000.000 denarë (731.707 euro).

Në listën e projekteve të planifikuara dhe të përealizuara nga zëri buxhetor 481 (Objekte ndërtimore) në Buxhetin e vitit 2022, nga shumica e institucioneve mund të veçohen edhe projekte të tjera, si për shembull:

- ndërtimi i objekteve industriale në ZZHTI 2 Shkup në vlerë prej 900.000.000 denarë (14.634.146 euro) nga Drejtoria për Zona Zhvillimore Teknologjiko-Industriale.
- blerja e patundshmërisë nga Agjencia për Siguri Kombëtare (ASK) në vlerë prej 140.000.000 denarë (2.276.423 euro)
- zgjerimi i kapaciteteve hapësinore të Agjencisë Teknike-Operative (ATO) në vlerë prej 25.000.000 denarë (406.504 euro)
- punime ndërtimore për një dhomë të mbrojtur në vlerë prej 33.000.000 denarë (536.585 euro), e cila ka qenë e paraparë të jetë në objektin e Kuvendit të RMV-së.

* * *

Analiza në pasojat e krizës energjetike dhe financiare në vitin 2022 mbi funksionet konkrete të Buxhetit nuk ishte e mundur për shkak të një gabimi të detektuar në Propozimin-Llogarinë Përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022. Edhe pse Ministria e Financave ishte e njoftuar dhe është kërkuar prej tyre që t'i bëjnë korigjimet e nevojshme, kjo megjithatë nuk u bë deri në përfundimin e kësaj analize.

Qëllimi i një analize të tillë ishte të demonstronohet ndikimi i krizave në vitin 2022 mbi funksionet e shtetit, duke e krahasuar lëvizjen e pjesëmarrjes së funksioneve konkrete të shtetit, në një periudhë kohore prej pesë vitesh.

Bëhet fjalë për funksionet e mëposhtme, të cilat mundësojnë që në mënyrë më sistematike të detektohen tendencat e politikave të cilat i zbaton shteti në raport me shpenzimet buxhetore dhe nga aspekti i ndikimit në jetën e njerëzve:


- ▶ Shërbime të përgjithshme publike;
- ▶ Mbrojtja;
- ▶ Rendi dhe qetësia publike;
- ▶ Çështjet ekonomike;
- ▶ Mbrojtje e mjedisit jetësor;
- ▶ Vendbanimet dhe komuniteti;
- ▶ Shëndetësia;
- ▶ Rekreacion, kulturë dhe feja;
- ▶ Arsimi dhe
- ▶ Mbrojtja sociale.

ANALIZA E DETYRIMEVE TË INSTITUCIONEVE

Tendenca të pafavorshme në vitin 2022 paraqesin gjithashtu detyrimet e institucioneve, edhe atë, si detyrimet e maturuara e të papaguara, ashtu edhe ato që nuk janë të maturuara e të cilat duhet të paguhen gjatë vitit rrjedhës apo në dy vitet e ardhshme fiskale. Me pak fjalë, tek të gjitha këto detyrime ka një rritje në vitin 2022 krahasuar me vitin paraprak, vitin 2021.


Detyrimet e përgjithshme të raportuara të subjekteve buxhetore në fund të vitit 2022 kanë qenë me shumën 49 miliardë denarë, përkatësisht 800 milionë euro dhe në raport me vitin 2021, tek ato ka pasur rritje për 186 milionë euro të reja, përkatësisht për 30%.

Gjithsej detyrime sipas subjekteve (në miliard denarë)



Ajo që është shqetësuese është se rritja më e madhe është te detyrimet të cilat janë bërë në vitin 2022, por pagesa e tyre është shtyrë për dy vitet e ardhshme fiskale.

Detyrime të paraqitura sipas subjekteve (në miliard denarë)



Detyrimet të cilat kanë maturuar në vitin 2022, ndërsa nuk janë paguar kanë qenë në shumën prej pothuaj 26 miliardë denarë, përkatësisht 420 milionë euro dhe në raport me vitin 2021, ato kanë qenë për 7% më të larta.


Detyrimet e pamaturuara për vitin rrjedhës 2022 kanë qenë në shumë prej 8 miliardë euro, përkatësisht 132 milionë euro, që paraqet rritje për 33% në raport me vitin e mëparshëm.

11 miliard denarë shtesë, përkatësisht 182 milionë euro, është shuma e detyrimeve të cilat shfrytëzuesit buxhetorë i kanë raportuar në vitin 2022 si detyrime të cilat maturaonë për vitin e ardhshëm, që paraqet rritje për 111% në raport me vitin paraprak.

Edhe 4 miliardë denarë, përkatësisht 65 milionë euro janë raportuar se duhet të maturaonë në vitin e ardhshëm fiskal, që është një rritje prej 88%.

Në të njëjtën kohë me rritjen e detyrimeve të institucioneve në të gjitha bazat - të maturuara dhe të papaguara, rrjedhëse dhe për vitet e ardhshme, rritet edhe numri i institucioneve të cilat kanë raportuar që kanë detyrime. Nëse në vitin 2020 detyrime kanë pasur 891 institucion, ndërsa vitin e ardhshëm 2021, kanë pasur 1063 institucione, në vitin 2022 madje 1205 institucione kanë raportuar se kanë detyrime.


Numër i institucioneve sipas detyrimeve të paraqitura



Sipas llojeve të shpenzimeve, gjithësi që detyrimet më të mëdha janë për pagesë të kredive jashtë vendit - 7 miliardë denarë, përkatësisht 116 milionë euro, me rritje për 800% në vitin 2022, në krahasim me vitin 2021.

Por, rritja e dytë më e madhe e detyrimeve në vitin 2022 është pikërisht për Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, për çka institucionet në fund të vitit 2022 kanë raportuar detyrime të papaguara në shumë prej 5 miliardë denarë, përkatësisht 87 milionë euro, që paraqet rritje në detyrimet për 45%, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Detyrimet më të larta sipas llojeve të shpenzimeve (në miliard denarë)




Sipas llojeve të subjekteve, detyrimet më të mëdha i kanë ndërmarrjet publike shtetërore, të cilat në fund të vitit 2022 kanë raportuar detyrime prej 21 miliardë denarë, përkatësisht 342 milionë euro, që përbën pjesëmarrje prej 43% në detyrimet totale të të gjitha subjekteve.

Pas tyre janë komunat dhe ndërmarrjet publike komunale, të cilat kanë raportuar detyrime prej afro

6 miliardë denarë, përkatësisht 93 milionë euro. Edhe komunat edhe ndërmarrjet publike, në vitin 2022 marrin pjesë me 12% në totalin e detyrimeve.

Më së paku detyrime kanë shfrytëzuesit buxhetorë të radhës së parë, me shumë rreth 2,5 miliardë denarë, përkatësisht 40 milionë euro.

Subjekte me detyrimet më të larta të paraqitura (në miliardë denarë)



kWh



PLANIFIKIMI DHE MONITORIMI I REALIZIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2022 – NEVOJA PËR HARMONIZIM TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË BUXHETIT

Realizimi i buxhetit të shtetit në kontekst të realizimit të të ardhurave buxhetore dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore të planifikuara, përkatësisht të deficitit buxhetor dhe borxhit publik, janë veglat kryesore për realizimin e politikave ekonomike të qeverisë.

Realizimi i buxhetit, me rebalanset e mundshme dhe vendimet për ridedikimin e mjeteve nga buxheti i shtetit (rialokim i mjeteve), është një "dokument" për ekspertë të cilët mund t'i vlerësojnë politikat e qeverisë, fokusin ekonomik të atyre politikave, drejtimin dhe ritmin e lëvizjes, por gjithashtu edhe t'i detektojnë politikat jokonsistente dhe populiste të cilat në afat të mesëm dhe afat të gjatë ndikojnë në mosrealizimin e rritjes potenciale, përkatësisht e zmadhojnë borxhin.

Hulumtimet në kuadër të këtij projekti kanë sugjeruar në dobësi të kontabilitetit buxhetor të bazuar në para të gatshme, mungesë të harmonizimit të raportimit financiar dhe evidentim të ndryshëm financiar të transaksioneve të njëjta juridike dhe ekonomike.

Gjithashtu, ekziston edhe një ngurrim tek institucionet shtetërore dhe lokale kur bëhet fjalë për bashkëpunim me sektorin civil në lidhje me dhënien e informacioneve më të hollësishme për shpenzimet buxhetore.

Për shkak të konsistencës së analizës në shpenzimet e buxhetit të realizuar kundrejt buxhetit të planifikuar të R. së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, fillimisht janë analizuar tendencat kryesore të pozicioneve bazë të financave buxhetore për një periudhë 5 vjeçare (2018 – 2022), veçanërisht duke i pasur parasysh shpenzimet e zmadhuara për shkak të KOVID-19 në vitin 2020 dhe shpenzimet e zmadhuara për shkak të krizës energjetike në vitet 2021 dhe 2022, por edhe ndikimin e inflacionit në të dyja anët e ekuacionit buxhetor (të ardhurat dhe shpenzimet), për vitet 2021 dhe 2022.


Veçoritë buxhetore të vitit 2020 (të shkaktuara nga KOVID-19) janë të dukshme, si në pjesën e dështimit me të ardhurat e mbledhura buxhetore, ashtu edhe për shkak të rritjes së madhe të shpenzimeve buxhetore, me përjashtim të shpenzimeve kapitale, tek të cilat ka një nivel të ulët të realizimit, por edhe për shkak të rritjes së deficitit buxhetor dhe borxhit shtetëror si dhe borxhit publik. Në vijim, përmes tabelave, grafikëve dhe komenteve të shkurtër, është ilustruar gjendja e buxhetit të shtetit për periudhën 2018-2022.

Realizimi i buxheteve prej R. së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2018-2022


viti	Të ardhurat buxhetore			Shpenzimet buxhetore			Deficiti buxhetor		Borxhi shtetëror dhe publik (shuma)	
	Gjendja		Dallimi [MKD (mil.)] (viti aktual-paraprak)	Gjendja		Dallimi [MKD (mil.)](viti aktual-paraprak)	Gjendja		Gjendja e borxhitit EUR (mil.)	Rritja vjetore EUR (mil.)
	DENARË (mil.)	EUR (mil.)		DENARË (mil.)	EUR (mil.)		DENARË (mil.)	EUR (mil.)		
2018	188,505	3,065	8,832	200,071	3,253	3,510	11,566	188	5,202.2	415,3
2019	203,822	3,314	15,317	217,445	3,536	17,374	13,623	222	5,540.9	338,7
2020	189,554	3,082	- 14,268	243,421	3,958	25,976	53,867	876	6,483.3	942,4
2021	218,021	3,545	28,467	256,906	4,177	13,485	38,885	632	7,135.3	652,0
2022	243,085	3,953	25,064	278,596	4,530	21,690	35,511	577	7,702.9	567,6

Rritja e të ardhurave buxhetore është ndërprerë në vitin 2020. Përkatësisht, në këtë vit, të ardhurat e realizuara janë në nivelin e vitit 2018, ndërsa shpenzimet buxhetore, pikërisht në vitin 2020 e kanë rritjen më të madhe në këtë periudhë pesëvjeçare. Rezultat i kësaj situatë është rritja e madhe e deficitit buxhetor në vitin 2020, që është më shumë se dyfishi i deficitit buxhetor në dy vitet e mëparshme (2018 dhe 2019). Deficiti në vitin 2020 është 4 herë më i madh se sa deficitit i vitit paraprak. Për periudhën 2018 - 2022 është gjeneruar një deficit buxhetor prej 2,5 miliardë euro, ndërsa nga kjo shumë, më tepër se dy miliardë euro deficit është gjeneruar vetëm në periudhën e tre viteve të fundit: 2020 - 2022.

Të ardhurat buxhetore, shpenzimet buxhetore dhe deficitit



Të ardhurat buxhetore, shpenzimet buxhetore dhe deficitit



Raporti relativ - Rritja/rënia e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore

viti	Të ardhurat buxhetore	Shpenzimet buxhetore
2018	4.9%	1.8%
2019	8.1%	8.7%
2020	-7.0%	11.9%
2021	15.0%	5.5%
2022	11.5%	8.4%

Indekset zinxhirë e shënojnë vitin 2020 si vit i pasigurt buxhetor dhe i financuar në deficit. Rënia e të ardhurave buxhetore për 7% dhe rritja e shpenzimeve buxhetore për 11,9% e paraqesin karakterin e deficitit të vitit buxhetor 2020, që është krijuar nga kostot e larta për shkak të krizës me KOVID-19.


Viti 2021 shënon gjoja rimëkëmbjen e financave buxhetore, ndërsa viti 2022 shënon gjoja edhe rikthimin e parametrave normal buxhetorë. Të ardhurat buxhetore janë rritur për 11.5%, ndërsa rritja e shpenzimeve është 8.4%. Megjithatë, në të dy vitet ka shpenzime të larta buxhetore të shkaktuara nga subvencionimi i importit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe nga subvencionimi i prodhimit të energjisë termike për nevojat e qytetit të Shkupit. Edhe pse më i vogël se në vitin 2020, deficitit buxhetor për vitet 2021 dhe 2022 është stabilizuar në shumë më të lartë se gjysmë miliard euro, në 632 milionë euro për vitin 2021 dhe 577 milionë euro për vitin 2022.

Për shkak të të ardhurave të vogla dhe shpenzimeve të larta buxhetore, deficitit buxhetor ka një rritje jashtëzakonisht të madhe, pothuaj për 4 herë në vitin 2020 krahasuar me vitin e mëparshëm. Kjo rritje e deficitit ndikon edhe në rritjen e madhe të borxhit shtetëror dhe borxhit publik, që në vitin 2020 është zmadhuar nga 40.5% (borxhi shtetëror) dhe 49.1% (borxhi publik) në 50.8% (borxhi shtetëror) dhe 59.7% (borxhi publik), që është matur në raport me produktin e brendshëm vendas.

Deficiti i lartë buxhetor nga viti 2020 e tutje vetëm sa e mpreh vetëdijen për kapacitetin e dobët të financave

publike të Maqedonisë: përkatësisht, shteti shpenzon tepër në raport me të ardhurat që i mbledh ose realizon shumë pak të ardhura në raport me atë se sa shpenzon. Rezultati i kësaj situatë në financat publike është financimi i deficitit dhe rritja e ngarkimeve me borxh.

Raporti relativ – Rritje/rënie e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore



Shpenzimet kapitale (milion denarë)


viti	Shpenzimet kapitale
2018	12,147
2019	17,812
2020	16,115
2021	23,408
2022	28.637

Shpenzimet kapitale në pesëvjetorin e analizuar, 2018-2022, janë në nivelin më të ulët në vitin 2020, me rënie në krahasim me vitin 2019. Në vitin 2021, shpenzimet kapitale kthehen në drejtimin e rritjes. Ne, i kushtojmë vëmendje rënies së lartë të shpenzimeve kapitale prej 38.8% në vitin 2018 dhe rritjes prej 46.6% tashmë vitin e ardhshëm. Rënia e shpenzimeve kapitale në vitin 2020 është 9.5%, pastaj vijojnë dy vjet rimëkëmbje, me rritje prej 45.3% në vitin 2021 dhe 22.3% në vitin 2022.

Duke e pasur parasysh raportimin jokonsistent financiar dhe evidentimin e ndryshëm të transaksioneve të njëjta afariste, krijohet një perceptim për cilësinë e dobët të të dhënave për lartësinë, lëvizjen dhe gjendjen e shpenzimeve kapitale, si dhe për ekzistimin e shpenzimeve rrjedhëse të cilat janë të evidentuara në

këtë grup zërash (llogari) buxhetorë, e që në thelb, nuk janë shpenzime kapitale.


Lëvizja e shpenzimeve kapitale



Raporti relativ – Rritja/rënia e shpenzimeve kapitale

viti	Shpenzimet kapitale
2018	-38.8%
2019	46.6%
2020	-9.5%
2021	45.3%
2022	22.3%

Borxhi shtetëror dhe publik (shuma): Rritja vjetore për periudhën 2018-2022



Të ardhurat buxhetore – Buxheti fillestar, rebalansi, realizimi i buxhetit të reviduar

viti	Të ardhurat buxhetore MKD (milion)	Ndryshimi zinxhir (%)	Rebalansi ² MKD (milion)	Ndryshimi në raport me buxhetin fillestar (%)	Realizimi MKD (milion)	% e realizimit të rebalansit buxhetor
2018	193,512	3.1 %	192,484	- 0.5 %	188,505	97.93 %
2019	210,848	9.0 %	210,551	- 0.1 %	203,822	96.80 %
2020	222,308	5.4 %	196,343	- 11.7 %	189,554	96.54 %
2021	212,630	-4.4 %	222,542	4.7 %	218,021	97.97 %
2022	238,899	12.4 %	245,758	2.9 %	243,085	98.91 %

Realizimi i buxhetit fillestar dështoi veçanërisht në vitin 2020; konkretisht, edhe pas rebalansit me të cilin plani i të ardhurave buxhetore është zvogëluar për 11.7%, realizimi ka një rënie prej 3.46%. Arsyeja kryesore e mbledhjes më të ulët të të ardhurave buxhetore është ngadalësimi i ekonomisë që u shkaktua nga kriza me KOVID-19. Rënia e përgjithshme e shumës së realizuar në raport me shumën e planifikuar të të ardhurave buxhetore në vitin 2020 është 14.7%. Për periudhën 2018-2020, të ardhurat

buxhetore të realizuara janë rregullisht më të ulëta nga ato që kanë qenë të planifikuara, ndërsa në vitet 2021 dhe 2022, realizimi tejkalon shumën e planifikuar të të ardhurave buxhetore.

² Në vitin 2020, buxheti ka pasur dy rebalanse.

BRUTO PRODHIMI VENDAS - TENDENCAT

Pas fillimit të krizës financiare botërore nga viti 2008, rritja e atëhershme e BPV-së në vlerë prej 6.5% (2007) dhe në vlerë prej 5.5% (2008) u bë negative në vitin 2009 (-0.4%) dhe u ngadalësua në periudhën që vijonte. Rënia më e madhe prej thujse 5% të BPV-së është në vitin 2020. Tabela e mëposhtme i paraqet kahjet e lëvizjes së BPV-së.

Bruto Prodhimi Vendas, 2007 – 2021						
viti	BPV me çmime aktuale (në milionë denarë)	BPV për kokë banori në euro (kursi aktual i këmbimit)	BPV në milionë euro (me kursin aktual të këmbimit)	Normat reale të rritjes së BPV-së në %	Deflatori i BPV-së	Norma e inflacionit (T) mesatar) në %
2007	372,889	2,982	6,095	6.5	104.6	2.3
2008	414,890	3,308	6,772	5.5	105.5	8.3
2009	414,622	3,300	6,767	-0.4	100.3	-0.8
2010	437,296	3,459	7,109	3.4	102.0	1.6
2011	464,186	3,665	7,544	2.3	103.7	3.9
2012	466,703	3,680	7,585	-0.5	101.0	3.3
2013	501,891	3,948	8,150	2.9	104.5	2.8
2014	527,631	4,141	8,562	3.6	101.4	-0.3
2015	558,954	4,382	9,072	3.9	102.0	-0.3
2016	594,795	4,659	9,657	2.8	103.5	-0.2
2017	618,106	4,839	10,038	1.1	102.8	1.4
2018	660,878	5,175	10,744	2.9	103.9	1.5
2019	692,683	5,423	11,262	3.9	100.9	0.8
2020	669,280	5,236	10,852	-4.7	101.4	1.2
2021 ^{1) 2)}	720,414	6,365	11,690	3.9	103.6	3.2
¹⁾ Të dhënat e mëparshme						2022
²⁾ Informacioni për BPV-në për kokë banori në euro është përlogaritur sipas numrit të popullsisë totale rezidente nga Regjistrimi i popullsisë në vitin 2021.						14.2

BUXHETI I R. SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2022

Buxheti prej R. së Maqedonisë së Veriut (Buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve) për vitin 2022 fillimisht është miratuar me shumën 284.001.434.000 denarë (4.617.909.495 euro). Me rebalansin e buxhetit për vitin 2022 është bërë rritje për 16.279.140.000 denarë, përkatësisht për 5,73%. Në buxhetin për vitin 2022 janë bërë rialokime me dy Vendime për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë. Realizimi i buxhetit është 98,9%, në vlerë prej 243,085 milionë denarë (rreth 3,95 miliardë euro).

Me rebalancin dhe dy Vendime për rialokim janë bërë ndryshime në projeksionet fillestare fiskale për buxhetin e vitit 2022.

Rritja e të ardhurave është bërë në koordinim me burimet e financimit të deficitit buxhetor, ndërsa rritja e planifikuar e shpenzimeve buxhetore ka për qëllim realizimin e një pjese të masave të Qeverisë për tejkalimin e pasojave të krizës energjetike.

Të ardhurat tatimore për vitin 2022	Inkasimi për vitin 2022 MKD (milion)	Inkasimi për vitin 2021 MKD (milion)	Ndryshimi 2022/2021
Tatimi mbi fitim	15,776	10,871	45.12 %
Tatimi mbi të ardhurat personale	23,852	20,552	16.05 %
Taksë mbi vlerën e shtuar	64,764	58,194	11.29 %
GJITHSEJ	104,392	89,617	16.49 %
Akciza	24,039	24,086	0.00 %
Tatim për mjete motorike	1,477	1,603	- 7.86 %
Detyrime dhe taksa tjera nga importi	8,496	6,877	23.54 %
Taksa të veçanta të njëfishta	20	22	- 10.00 %
Tatime komunale	13	9	54.00 %
Lejet për kryerje të veprimtarisë	637	610	4.43 %
GJITHSEJ	139,074	122,824	13.23 %

Tabela përmban të dhëna nominale të cilat nuk janë korigjuar me deflator. Për ilustrim, shkalla mesatare e inflacionit, e matur sipas rritjes së kostove për jetesë, për vitin 2022 është 14.2%. Kjo e dhënë nënkupton që rritja e të ardhurave, veçanërisht tek tatimi mbi vlerën e shtuar, është shkaktuar kryesisht nga rritja e çmimeve dhe jo nga qarkullimi më i madh.

Deficiti buxhetor për vitin 2022 është 4.5% e BPV-së dhe paraqet 0.3 pikë të përqindjes më shumë nga projektimi prej 4.2%. Deficiti buxhetor në vitin 2021 është 5.4%, që paraqet një stabilizim të caktuar të financimit dhe zvogëlim të deficitit buxhetor në vitin 2022.

Pavarësisht zvogëlimin e deficitit, pjesëmarrja e tij në BPV për vitin 2022 është në nivel më të lartë krahasuar me vitet para krizës me COVID-19.

Për shkak të shfrytëzimit të sistemit të kontabilitetit rrjedhës, cilësia e informacioneve për deficitin dhe të ardhurat e arkëtuara, përkatësisht shpenzimet e paguara nuk është e lartë, gjë që është shkaktuar nga mundësia e bartjes së detyrimeve të papaguara për periudhën e ardhshme buxhetore për të paraqitur një deficit buxhetor më të ulët për vitin raportues.

Në pjesën e financimit, vërehet rënia e shpenzimeve në bazë të shlyerjes së kryegjësë në vlerë prej 11,4 miliardë denarë për vitin 2022, në krahasim me 42,6 miliardë denarë shlyerje për vitin 2021. Zvogëlimi i shlyerjes së kryegjësë rezulton nga pagesa e plotë e eurofletëobligacionit të 3-të nga viti 2014, i cili maturon në vitin 2021. Pagesat e normave të interesit kanë përafërsisht të njëjtin nivel të pjesëmarrjes në totalin e shpenzimeve në vitin 2022 (3.3%), krahasuar me vitin 2021 (3.5%).

Transferi për financimin e deficitit të Fondit SPI për vitin 2022 është në shumë 78.394 milionë denarë, merr pjesë me 28% të shpenzimeve buxhetore dhe është afërsisht në të njëjtin nivel të vitit 2021.

Në pjesën e realizimit të buxhetit për vitin 2022, janë paraqitur situata të cilat ndikojnë në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe të hyrave tjera si dhe planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve dhe pagesave tjera, financimin e deficitit buxhetor, kontrollet e vendosura në DAP dhe në Drejtorinë Doganore për të mbuluar rreziqet gjatë përllogaritjes, evidentimin dhe arkëtimin e të ardhurave tatimore. Totali i të ardhurave dhe të hyrave në vitin 2022 është realizuar në vlerë prej 243.085 milionë denarë, përkatësisht për 11,5% më tepër në krahasim me vitin 2021. Tek të ardhurat tatimore, administrimi dhe realizimi i të cilave është kryesisht në kompetencë të DAP-së dhe Drejtorisë Doganore dhe të cilat përfaqësojnë 69% të të ardhurave të buxhetore të vitit 2022, është vërejtur rritje në raport me vitin paraprak, veçanërisht tek tatimi mbi fitim për 45%. Për sa i përket kërkesave dhe detyrimeve për tatime, kontribute dhe detyrime tjera publike, konstatuam që ato nuk janë të paraqitura në raportet financiare,

gjë që e ul transparencën e projeksioneve buxhetore, ndërsa mungesa e të dhënave për strukturën e moshës së kërkesave në bazë të tatimeve krijon rrezik për vjetërimin dhe pamundësi për arkëtimin e tyre.

Ministria e Financave e bën planifikimin e të ardhurave jotatimore dhe të ardhurave kapitale si të ardhura që priten në Buxhet mbi bazën e shpërndarjes së mjeteve të tepërta të realizuara nga puna e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare në pronësi shtetërore, ndërkaq në bazë të informacioneve për fitimin e realizuar, për shkak se në Ministri nuk dorëzohet dokumentacion për mënyrën e shpërndarjes së fitimit, përkatësisht për pjesën që mbetet për t'u paguar në Buxhet.

Shpenzimet dhe pagesat totale të Buxhetit për vitin 2022 janë 278.596 milionë denarë dhe janë për 4,4% më të larta se në vitin 2021. Në vitin 2022 vërehet zmadhim tek të gjitha shpenzimet krahasuar me vitin paraprak dhe më së shumti në pjesën e shpenzimeve kapitale dhe të rezervave dhe shpenzimeve të papërcaktuara. Rënia më e madhe prej 73% është vërejtur te shpenzimet për shlyerjen e kryegjësë, për faktin që në vitin paraprak është bërë pagesa e plotë e euro-fletëobligacionit të tretë të emetuar në vitin 2014, ndërkaq i cili maturon në vitin 2021. Për mbulimin e deficitit të Fondit për SPI për pagesë të pensioneve, i cili në vitin 2022 është 22% nga burimet përgjithshme të mjeteve për pagesë të pensioneve, janë transferuar mjete në shumë 14.851 milionë denarë dhe deficitit është zvogëluar për 7% në raport me vitin 2021.

Në vitin 2022, nga funksionet shtetërore janë paguar mjete në vlerë prej 1.051 milion denarë me vendime të Qeverisë, të cilat në krahasim me vitin 2021 kanë shënuar rënie të konsiderueshme prej 49%. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve, 59% janë për rritjen e kapitalit të Bankës Zhvillimore.

Në strukturën e programeve qeveritare, pjesëmarrjen më të madhe e zënë mjetet për programin A - Decentralizim, si dhe P1 - Masat për përbalim me krizën COVID-19 dhe masat tjera antikrizë, ndërsa nënprogramet zhvillimore të qeverisë të cilat janë pjesë përbërëse e pjesës zhvillimore të buxhetit marrin pjesë vetëm me 13,86 % në totalin e shpenzimeve të parashikuara për programet e qeverisë.

Edhe pse me një transparencë dukshëm të përmirësuar në krahasim me periudhën e mëhershme, veçanërisht pas aktivizimit të platformës “Financa të Hapura”, prapë se prapë, informacionet për shpenzimet buxhetore sipas llogarive analitike (llogaritë gjashtëshifrore) nuk janë konsistente, të mjaftueshme dhe mund të çojnë në konkluzione të gabuara dhe në këtë mënyrë të ndikojnë në vendimet e miratuara nga shfrytëzuesit buxhetorë dhe njësitë shfrytëzuese.

Nëpërmjet llogarisë për shpenzime kapitale 485 (Investime dhe pasuri jofinanciare), në disa raste, me vendime të Qeverisë për miratimin e mjeteve financiare për ballafaqimin me situatën e krizës për furnizim me energji elektrike/termike, është bërë pagesë nga

buxheti për vitin 2022 në favor të SHA ESM (mjetet e siguruara nga programi P – Masat për ballafaqim me krizën KOVID-19 dhe masa tjera antikrizë), nënprogrami P1 (Masat për ballafaqim me krizën KOVID-19 dhe masat tjera antikrizë).

Pagesa në favor të SHA ESM, Shkup është bërë përmes të njëjtit program, por duke e përdorur zërin buxhetor të shpenzimeve 464 - Transfere të ndryshme (Vendimi 188/2022).

Kjo mospërputhje e raportimit financiar për të njëjtin lloj të shpenzimeve në llogari të ndryshme buxhetore sugjeron në nevojën për një zbatim të unifikuar të raportimit në drejtim të përgatitjes së raporteve që do të kenë vlerë të dobishme për vendimmarrësit politikë.

SHA ESM Termocentralet e Maqedonisë së Veriut (Raporte financiare sipas viteve) (milion denarë)

PËRSHKRIM	viti 2021	viti 2022
Të ardhurat totale	15,957	34,093
Subvencione të Qeverisë (të përfshira në të ardhurat totale)	5,924	10,232
Shpenzimet totale	17,685	31,579
Rezultati financiar para tatimit	- 1,728	2,514

Burimi: Raporti Vjetor Financiar i ESM-së për vitin 2022, nr. 05-1173/1 më 28 shkurt 2023, mund ta gjeni në këtë link:
<https://www.esm.com.mk/wp-content/uploads/2023/04/AD-ESM-Godisen-Finansiski-izvestaj-za-2022.pdf>

Në tremujorin e fundit të vitit 2021, Qeveria e ka mbështetur ESM-në me mjete buxhetore në shumë prej 5.294 milionë denarë, përkatësisht 96 milionë euro. Këto mjete janë evidentuar si të ardhura të ESM-së për vitin 2021.

Nga mjetet e pranuar, për blerje të energjisë elektrike, ESM në vitin 2021 ka shpenzuar 4.504.835 denarë, përkatësisht 73,2 milionë euro, ndërsa pjesën tjetër prej të mjeteve prej 789.165.000 denarë, përkatësisht 12,8 milionë euro e ka shpenzuar për të njëjtin dedikim në vitin 2022.

Me mjetet e bartura të pashpenzuara nga viti 2021, ESM në vitin 2022 ka menaxhuar me 178,8 milionë euro (11.021.514 mijë denarë) për blerje të energjisë elektrike për vitin 2022. Kjo shumë merr pjesë me 4% në shpenzimet totale të buxhetit të Maqedonisë për vitin 2022.

Në procesin e analizës së shpenzimeve kapitale³, si zë i buxhetit që duhet të përmbajë shpenzimet e shtetit të cilat bartin komponentë zhvillimorë, mund të konstatohet se në grupin e llogarive 48 – Shpenzime kapitale, evidentohen shpenzime heterogjene, një pjesë e konsiderueshme e të cilave nuk mund të klasifikohen në kategorinë “kapitale”.

Për shkak të transparencës së procesit buxhetor si dhe përmirësimit të bazës së evidencës për miratimin e vendimeve relevante nga politikëbërësit buxhetorë, është e nevojshme të veçohen disa nga këto shpenzime nga ky grup llogarish. Me këtë, nga shpenzimet kapitale do të pastrohet pjesa e shpenzimeve të cilat në thelb nuk i përkasin këtij grupi, me fjalë tjera, pjesa e shpenzimeve të cilat e turbullojnë cilësinë e llogarisë, por edhe sasinë e saj.

Vërejtjet janë në lidhje me shpenzimet “kapitale” të mëposhtme:

- ▶ TVSH e paguar për pajisjet e blera nga donacionet – llogaria 480;
- ▶ Blerje mobiljesh (mobilje për zyre) – llogaria 483;
- ▶ Ilaçe dhe materiale sanitar, produkte ushqimore dhe produkte industriale – llogaria 484;
- ▶ Depozita, letra me vlerë, kredi për komunitat, kredi studentore, kredi për ndërmarrjet publike dhe private, pagesa të garancive, aksione dhe kapital tjetër nga investitorë vendas dhe të huaj, libra për bibliotekata dhe libra shkollorë – llogaria 485;
- ▶ Blerje e mjeteve motorike – llogaria 486;
- ▶ Transfere në fondet jashtëbuxhetore, SPIM, Agjencia për Punësim, Fondi për Sigurim Shëndetësor, Agjencia për Rrugë Shtetërore – llogaria 487;

3 Rregullore për përmbajtjen e llogarive të veçanta në planin kontabël për buxhetet 79/03; 96/04; 88/09 dhe 175/11.

- ▶ Subvencione për ndërmarrjet, organizatat joqeveritare, institucionet – llogaria 489.

Analiza e realizimit të buxhetit sugjeron në dobësi të pjesa e të dhënave për marrëdhëniet e vendosura debitorë-kreditorë për të cilat nuk është realizuar pagesa, përkatësisht sugjeron në mungesën e informacioneve në sistemin e kontabilitetit buxhetor për gjendjen e kërkesave dhe detyrimeve që nuk janë arkëtuar, përkatësisht nuk janë paguar.

Kombinimi i këtyre dy njoftimeve brenda një sistemi informativ do të mundësojë kontrollin në likuiditetin aktual, por edhe analizë të përshtatshme të synimeve dhe nevojave afatgjata financiare të shtetit, duke përfshirë edhe evidencën e pronës totale të shtetit.

Buxhetimi për llogaritës është më i rëndësishëm për menaxherët e buxhetit (planifikuesit dhe analistët e buxhetit) sesa për politikanët për të cilët rëndësi ka grumbullimi dhe shpenzimi efektiv i buxhetit gjatë mandatit. Duke e pasur parasysh cilësinë e informacioneve të cilat i jep sistemi për llogaritës i evidencës buxhetore, është e qartë që ky sistem i ngërthen informacionet nga evidenca e buxhetit të parave të gatshme dhe u shton vlerë transaksioneve të pritshme në të ardhmen - informacion që ka rëndësi të veçantë edhe për politikanët nga aspekti i planifikimit të buxhetit.

Përveç segmentit të kërkesave dhe detyrimeve të për llogaritura për të cilat janë krijuar marrëdhëniet debitorë-kreditorë, mungojnë të dhëna për gjendjen me pronën e shtetit në një bilanc të vetëm të gjendjes.

Në procesin e përpunimit të këtij materiali, është vërejtur mospërputhshmëri në raportimin e shpenzimeve të njëjta buxhetore të evidentuara në llogari të ndryshme buxhetore. Përveç mungesës së harmonizimit, një nga arsytet e mundshme për mospërputhje të tilla është përpjekja për mbulimin e shpenzimeve të paarsyetuara buxhetore, përkatësisht transferimin e zërave që tashmë janë harxhuar dhe për të cilët nuk ka mjete në planet aktive financiare.

PROPOZIME-REKOMANDIME

- Për shkak të transparencës së procesit buxhetor si dhe përmirësimit të bazës së evidencës për miratim të vendimeve relevante nga politikëbërësit buxhetorë, është e nevojshme që një pjesë e shpenzimeve nga zëri buxhetor 48 – Shpenzime kapitale të ndahen nga ky grup i llogarive. Me këtë, nga shpenzimet kapitale do të “pastrohet” pjesa e shpenzimeve të cilat për nga thelbi i tyre nuk i përkasin këtij grupi, përkatësisht e turbullojnë cilësinë e llogarisë, por edhe sasinë e saj.
- Shfrytëzuesit buxhetorë duhet të bëjnë përpjekje shtesë për realizimin sa më të plotë të buxheteve të planifikuara. Në veçanti, duhet bërë përpjekje për përshpejtimin e tempit të realizimit të projekteve nga zëri buxhetor për shpenzimeve kapitale për t’u tejkaluar situata me bartjen e realizimit të disa projekteve të rëndësishme nga viti në vit.
- Të publikohet evidenca analitike me llogaritë analitike gjashtëshifrore të buxheteve dhe e çdo dokumenti përkatës, me format të përshtatshëm për analizë. Njëkohësisht, çdo raporti tremujor duhet t’i bashkëngjiten shënime me arsyetimin e zërave të veçantë buxhetorë, në të cilat, para së gjithash, shpenzimet do të evidentohen në llogaritë nën-analitike duke i përmendur arsyet për dallimet e prezantuara.
- Të zbatohet kodifikimi i evidencës për shkak të shmangies së evidentimit të llojit të njëjtë të shpenzimeve, të ardhurave, mjeteve dhe detyrimeve të shfrytëzuesit dhe njësitë shfrytëzuese të ndryshme buxhetore.
- Pagesa e borxheve të papaguara nga buxheti aktual dhe transferimi i pagesave për projektet rrjedhëse për vitin e ardhshëm e pamundësojnë saktësinë maksimale në konstatimin e vlerës së projekteve dhe aktiviteteve të planifikuara të cilat nuk janë realizuar. Ky është një problem kryesisht i vërejtur në shumicën e institucioneve. Kjo e shton nevojën për llogaridhënie më të madhe ndaj qytetarëve në nivel projektesh dhe aktiviteteve, e jo në nivel të zërave buxhetorë.
- Të ngritet niveli i informimit të publikut për detyrimet e institucioneve, si për detyrimet e maturuara e të papaguara ashtu edhe për detyrimet që nuk janë maturuar dhe duhet të paguhen në vitin aktual apo në vitet e ardhshme fiskale. Kështu, duhet të ndikohet në drejtim të prioritizimit të shpenzimeve nga ana e institucioneve dhe drejt nevojës për racionalitet dhe ekonomizim më të madh në shpenzimet.
- Është e nevojshme që gradualisht të kalohet në aplikimin e plotë të sistemit të kontabilitetit për llogaritës, në vend të raportimit aktual të bazuar në para të gatshme. Njoftimet e pjesshme për detyrimet sipas skadencës, përkatësisht për kërkesat, të zëvendësohen me një sistem të plotë kontabël në bazë për llogaritëse. Për këtë qëllim, të përkthehen dhe të publikohen të gjitha Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për sektorin publik, të bëhen ndryshimet e duhura ligjore dhe të miratohen aktet nënligjore. Procesi të zbatohet gradualisht, me trajnimin e personelit profesional që punon në kontabilitetin e sektorit publik/buxhetor.
- Shfrytëzuesit buxhetorë duhet të zmadhojnë transparencën dhe llogaridhënien në drejtim të dhënies së të dhënave më të detajuara dhe më të kuptueshme lidhur me shpenzimet buxhetore. Ky rekomandim buron nga përpjekjet e jashtëzakonshme që ishin të nevojshme për t’i siguruar të dhënat për projektet kapitale të përealizuara. Në këtë drejtim, është i nevojshëm evidentimi dhe publikimi i informacioneve të standardizuara të bazuara në prova për: projektet e planifikuara në nivel vjetor, shkallën e realizimit të tyre, shkaqet për realizimin e vonuar dhe tejkalimet e planeve financiare.
- Të vendoset detyrimi për informim të qytetarëve në nivel vjetor për të gjitha projektet e planifikuara dhe të përealizuara si dhe për shkurtimet në buxhet të

cilat janë në lidhje të drejtpërdrejtë me dhe ndikojnë në jetën e qytetarëve.

- Në të ardhmen duhet të parashihen mekanizma dhe mënyra që shkurtime të buxhetore, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, të mos kompensohen me kredi të reja dhe "marrje" parash nga ato projekte dhe fonde nga të cilat, drejtpërsëdrejti varet jeta e njerëzve, por nga ata "zëra" buxhetorë që nuk kanë ndikim të tillë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë te qytetarët dhe në jetën e tyre.
- Miratimi i vendimeve për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve nga ana e Kuvendit të RMV-së në të ardhmen duhet të kushtëzohet me detyrimin për përgatitjen e dokumentit për Buxhetin e ndryshuar. Në fakt, me praktikën e deritanishme bëhet e pamundur këqyrja e publikut në zërat real të buxhetit të miratuar.
- Duke qenë se misioni i fundit në terren i Fondit Monetar Ndërkombëtar ka për qëllim identifikimin e gjendjes me shpenzimet buxhetore dhe propozimin e një strukture të përshtatshme për institucionalizimin e funksionit për këqyrje të shpenzimeve në vend, vërehet një përjashtim i plotë nga ky proces edhe te palët tjera të interesit, krahas institucioneve shtetërore. Kjo sjellje është pasojë e mbylljes së Ministrisë së Financave ndaj organizatave të shoqërisë civile, që në veçanti ishte e theksuar në vitin e kaluar.
- Ministria e Financave duhet të jetë më e reaktive në korigjimin e gabimeve në të dhënat e publikuara me qëllim që të mundësojë informim të kohshëm dhe të saktë të publikut. Ky rekomandim imponohet nëse merret parasysh që Propozim-Llogaritë Përfundimtare për vitet 2022 dhe 2020, si dhe Llogaria Përfundimtare për vitin 2020 përmbajnë të dhëna të pasakta në raport me vlerën e shpenzimeve në nivel të kategorive funksionale: shërbime publike të përgjithshme, mbrojtja, rendi dhe qetësia publike, çështjet ekonomike, mbrojtje e mjedisit jetësor, vendbanimet dhe zhvillim i komunitetit, shëndetësia, rekreacioni, kultura dhe religjioni, arsimit dhe mirëqenia sociale.
- Të gjitha të dhënat që janë në lidhje me shpenzimet buxhetore, siç janë buxhetet, llogaritë përfundimtare, raportet për të ardhurat dhe shpenzimet e shfrytëzuesve buxhetorë, etj., duhet të publikohen në një format të hapur për të qenë i mundshëm përdorimi, përpunimi dhe analizimi e mëtejshëm i tyre.

MATERIALET DHE BURIMET E TË DHËNAVE QË JANË PËRDORUR

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 287/2021

Sistemi elektronik për Prokurime Ppublike

Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2018

Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019

Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020

Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas subjekteve për periudhën dhjetor 2022

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas grupeve të subjekteve për periudhën dhjetor 2022

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojit të shpenzimeve për periudhën dhjetor 2022

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojeve të komitentëve për periudhën dhjetor 2022

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas subjekteve për periudhën dhjetor 2021

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas grupeve të subjekteve për periudhën dhjetor 2021

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojit të shpenzimeve për periudhën dhjetor 2021

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojeve të komitentëve për periudhën dhjetor 2021

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas subjekteve për periudhën dhjetor 2020

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas grupeve të subjekteve për periudhën dhjetor 2020

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojit të shpenzimeve për periudhën dhjetor 2020

Raport mbi detyrimet e raportuara sipas llojeve të komitentëve për periudhën dhjetor 2020

Realizimi i buxheteve të NjVL-ve për periudhën 11.-31.12.2022

Realizimi i buxheteve të NjVL-ve për periudhën 11.-31.12.2021

Ndryshime dhe plotësime të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, Gazeta Zyrtare e RMV-së, numër 164/2022

Vendim për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, Gazeta Zyrtare e RMV-së, numër 232/2022

Vendim për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, Gazeta Zyrtare e RMV-së, numër 272/2022

Financa të hapura

Rregullore për klasifikimin e të ardhurave, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 76/2009

Rregullore për klasifikimin e shpenzimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 76/2009

Propozim-Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022

Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar 2022

Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar-dhjetor 2022

Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar 2021

Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar - dhjetor 2021

